




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 43, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenin 3 paragrafi 1 pika 1.2 dhe neni 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 37 pika 1,3 të Statutit të Komunës së Skenderajt nr.01-110-385, i dt.03.12.2008, si dhe neni 5 Rregullores së Punë se Kuvendit, si dhe ne pajtim me rregullat e procedurës për mbajtjen e mbledhjeve, Kryesuesja e Kuvendit, znj. Adelina Spahiu:

THE RRET

Mbledhjen e Rregullt të Kuvendit Komunal të Skenderaj, e cila do të mbahet me datë 30.05.2024, (ditë e enjte), me fillim prej orën 10:00, në Sallën e Kuvendit

Mbledhja do të ketë këtë:

REND DITE

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara;
4. Propozim-vendim për rishqyrtimin e vendimit Nr.01-020/01-0016897/24, i datës 03.04.2024, për themelimin e komisionit të kuvendit komunal për zgjedhjen e këshillave lokale, me Nr.02-020/01-0023062/24, të datës 15.05.2024, (Raporton Kryetari i Komunës **z. Fadil Nura**);
5. Propozim-vendim për shfuqizimin në tersi të vendimi Nr.01-020/01-0016899/24, të datës 03.04.2024, për formimin e komisionit për ndarjen e banesave për familjet (të ngushta) të Dëshmorëve të UÇK-së, me Nr.02-020/01-0023060/24, të datës, (Raporton Kryetari i Komunës **z. Fadil Nura**);
6. Propozim-vendim për shfuqizimin në tersi të vendimi Nr.01-020/01-0016898/24, i datës 03.04.2024, për themelimin e komisionit të kuvendit komunal për shqyrtimin e ankesave përkitazi për ndarjen e banesave për familjet e Dëshmorëve të UÇK-së, me Nr.02-020/01-0023061/24, të datës 15.05.2024, (Raporton Kryetari i Komunës **z. Fadil Nura**);
7. Propozim-vendim për miratimin paraprak të vendimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej 1 (një), deri 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite pronën e paluajtshme të komunës objektin banesor që gjendet në parcelën P-72015063-00671-0, me Nr.02-463/01-0023751/24, të datës 21.05.2024, (Raporton Kryetari i Komunës **z. Fadil Nura**);
8. Propozim-vendim për miratimin e vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë deri 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite pronën e paluajtshme të komunës objektin banesor qe gjendet në parcelën P-72015063-00671-0, me Nr.02-020/01-0023754/24, të datës 21.05.2024, (Raporton Kryetari i Komunës **z. Fadil Nura**);
9. Propozim-vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës së Skenderajt, me pronën e paluajtshme të personit fizik Mujë Hoti, me Nr.02-463/01-0023907/24, të datës 22.05.2024, (Raporton drejtoresha e DGJKP-së, **znj.Blerta Dobra-Geci**);


10. Propozim-vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës së Skenderajt, me pronën e paluajtshme të personit fizik juridik Ismet I. Mustafa B.I., me Nr. 02-463/01-0023908/24, të datës 22.05.2024, (Raporton drejtoresha e DGJKP-së, **znj. Blerta Dobra-Geci**);
11. Propozim-vendim për rishqyrtimin dhe miratimin e dokumentit Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2024-2028 për Komunën e Skenderajt, të harmonizuar sipas kërkesës së MAPL-së, me Nr.12-313/01-0023818/24, të datës 21.05.2024, (Raporton Drejtoresha e DZHENIT-së, **znj. Besarta Meha-Ademi**);
12. Propozim-vendim për miratimin e Programit komunal trevjeçar për banim 2024-2026, në Komunën e Skenderajt, me Nr.08-060/01-0023492/24, të datës 20.05.2024, (Raporton drejtoresha e DSHMS-së, **znj. Rrezarta Hasani-Ibrahimi**);
13. Pyetjet e këshilltarëve nën pikat të ndryshme.

KRYESUESJA E KUVENDIT
znj. Adelina Spahiu





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 49, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, të datës 03.12.2008, si dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit nenit 27, e në pajtim me rregullat e procedurës.

Ekstrakt nga procesverbalit i MBLEDHJES SË KUVENDIT KOMUNAL SKENDERAJ,
i datës 30.04.2024, ora 13:00.

Në këtë mbledhje janë diskutuar këto pika:

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara;
4. Shqyrtimi i Raportit financiar tremujore, Janar-Mars 2024, me Nr. 02-052/01-0018545/24, të datës 15.04.2024, (Raporton drejtori i DBF-së, **z. Ismet Aliu**);
5. Informatë lidhur me bursat për studentë, për vitin shkollor 2023/2024, nga Drejtoria e Arsimit, me Nr.07-670/01-0018899/24, të datës 16.04.2024, (Raporton drejtori DKA-së, **z. Kastriot Duraku**);
6. Informatë mbi gjendjen e banimit social në komunën e Skenderajt në periudhën Janar-2023, Mars-2024, me Nr.08-360/01-0019827/24, të datës 22.04.2024, (Raporton drejtoresha e DShMS-së, **znj. Rrezarta Hasani-Ibrahimi**);
7. Pyetjet e këshilltarëve nën pikat të ndryshme.

Kryesuesja e Kuvendit, znj. Adelina Spahiu: I nderuar kryetar i komunës z. Fadil Nura, të nderuar anëtar të kuvendit, drejtor të drejtorive, shoqëri civile dhe gjithë ju të pranishëm, Kjo seancë është thirrur në ora 10:00, po është shtyre për ora 13:00, për arsye të përvjetorit të Ilaz Kodrës. Shkojmë në konstatime të kuorimit në sallë janë 28 anëtar, mungon me arsye Nexhat Ahmeti dhe Osman Smajli, ndërsa mungon pa arsye Arjeta Rama.

Para se të fillojmë me punimet e kësaj seance, kërkoj ta nderoj me një (1) minutë heshtje shënimit të 25 vjetorit të sakrificës të heroit Ilaz Kodres, dhe 315 dëshmorëve dhe martirëve tjerë të renë me 30 prill 1999, ...LAVDI...

Shkojmë me miratimin e rendit të ditës, e hap debatin, fjalën ja kaloj:

Hysni Mehani-VV: Fjala përshëndetëse, nuk po e shoh drejtorin e bujqësisë Behxhet Maliqi, nuk e di a është këtu, po ajo që është e nevojshme prej ti është me pas një raportim për drejtorin e bujqësisë, nëse sot nuk mundet me na sjell një raport, në seancën e kaluar me na sjellë, së unë po provoj me hulumtua një situatë që ka të bëjë me grandet me subvencionet në bujqësi dhe kërkesa për qasje në dokumente zyrtare po me mënjanohet vazhdimisht po shkon deri në ditën e fundit, pra letë vjen këtu drejtori e të debatojmë për shkeljet që është tu i bë?. Tjetra 30 prilli së cili prej neve e kemi përjetua, edhe ish kanë dashur për shkak të rrethanave mos me u thirr kjo seancë, po me qenë së është thirr po vazhdojmë, po ti keni parasysh këto data, së për besë nuk mundet me qenë të zakonshme.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Kryetari të Komunës, Fadil Nura: Fjala përshëndetëse, sa i përket kërkesës, për sjelljen e raportit të drejtorit të bujqësisë, unë e di që e keni një plan punës të kuvendit, që është i miratuare

në këtë kuvend, ku parashihen raportet, informatat e çdo drejtorie, po si do që të jetë raportin e drejtorit të bujqësisë në seancën e ardhshme mundeni me pas në seancë me i diskutua çështjet që ju i vlerësoni të nevojshme, drejtori i bujqësisë sot nuk ka ardhur në seancë me leje për arsye të angazhimeve.

Kryesuesja; Dikush tjetër nëse nuk ka, konstatojmë me (18) vota për, (0) kundër dhe (7) abstenim, Miratohet Rendi i Ditës.

Vazhdojmë me piken 3 të rendit të ditës,

Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara, e hapë debatin, nëse nuk ka konstatoj me (28) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet procesverbali nga mbledhja e kaluar.

Vazhdojmë me piken 4 të rendit të ditës,

Shqyrtimi i raportit financiar tremujore, Janar-Mars 2024, me Nr. 02-052/01-0018545/24, të datës 15.04.2024, (Raporton);

Drejtori i DBF-së Ismet Aliu; Fjala përshëndetëse, para vetes e keni Raportit financiar tremujore, Janar-Mars 2024, ky është raporti i parë i rregullt për këtë vite sipas legjislacionit në fuqi, që paraqet të gjitha të hyrat dhe shpenzimet për këtë tre mujorë. Buxheti fillestarë është 18,582,310.00€, ky buxhete për momentin nuk ka pësuar ndryshime. Buxheti është shpenzuar për këtë tre muaj me 26.52%, në Paga shtesë 24.90%, Mallra dhe shërbime 29.05%, Shërbemë Komunale 28.12%, Subvencione 24.20%, dhe Investime Kapitale 29.48%. Të hyrat vetanake kanë arritur në shumë 305,958.37€, me 23.55%, nga të gjitha burimet, kemi rënje të hyrave në krahasim me vitin e kaluar për këtë periudhë diku 45.06% që ka ndikuar në faljen e tatimit në pronë. Projektet kapitale të planifikuara janë 4,374,710.00€, të shpenzuara janë 1,289,736.24€, ne përqindje 29.48%, dhe në fund e keni shpenzimin e buxhetit neper drejtori dhe zyra, në detaje sipas nen kodeve ekonomike.

Kryesuesja; E hap debatin, fjalën ja kaloj:

Hysni Mehani-LVV: Drejtor në këtë raporte tre mujor sa po shoh janë tërhiqe shpenzimet e drekave zyrtare nga raportimi, cila është arsyeja, së besoj kjo është çështje e rëndësishme, vitin e kaluar zyra e kryetarit për Dreka zyrtare i ka pas afër 11 mijë euro, Derivate për automjete i ka pas 11 mijë euro, Shërbime tjera 12 mijë euro, drejtor pse është e rëndësishme me i mëshëf këto të dhëna, së kjo çdo herë është raportua prej së jam unë këshilltarë komunal, shohë së ka rritje të shpenzimeve tjera, si të Drutë dhe prodhimet e drurit për ngrohje, me krahasim me vitin e kaluar, a është borxh paraprak apo çfarë. Po me shume po me intereson pse drejtor po i meshefni raportimet, po ndërroni po ri-emëroni kode buxhetore sa me krijua një farë paqartësie?

Illir Ejupi-IDEAL: Fjala përshëndetëse, Drejtor të shpenzimet për akomodim-udhëtime jashtë vendi, për cilat udhëtime behet fjalë?

Sala Jashari-E PAVARUR: Fjala përshëndetëse, të Shpenzimi i provojës së punës ku janë 124,838.46€, a mundesh me na dhënë detaje për këtë shpenzim drejtor?

Afrim Kabashi-NSD: Fjala përshëndetëse, pasi që shumica e kolegëve veç i than, drejtor për vitin 2022 në të dhënat që na ke publikuar në raportin e auditimit raporti financiar ka dalë mirë, për vitin 2023 me sa e di kemi pas auditimë, a janë audituar pasqyrat financiare dhe a e keni pranuar draft-raportin që e keni pas mbi pasqyrat financiare për vitin 2023 nëse po cilat janë rezultatet e auditimit?

Kryesuesja; Fjalën ja kaloj

Drejtori i DBF-së Ismet Aliu; Sa i përket shpenzimeve për dreka zyrtare, ka ndryshua kodi buxhetor, tani e tutje nuk quhen me shpenzime për dreka zyrtar, e tash është kodi 14310 Kompensimi i përfaqësimit brenda vendit, dhe ky kodë është krijuar nga Ministria e financave, departamenti i thesarit, dhe këto kode nuk i emërtojmë ne, dhe nuk janë rritë nëse i shikojmë me

vitet paraprake të kësaj periudhe, dhe as një shifër as një detaj nuk është mësues të gjitha janë të shpalosura në këtë raport. Shpenzimet për akomodim-udhëtime jashtë vendi, janë shpenzime që kanë qenë zyrtaret jashtë vendi, mundën me qenë obligime edhe nga vitet paraprake po ky raport i pasqyron të gjitha shpenzimet që kanë ndodhur në këtë vite, dhe sigurisht ka obligime edhe nga vitet paraprake. Të kategoria e Përvoja e punës, ne për herë të parë e kemi specifikuar në raport, është përvoja e punës të zyrtarëve të shërbyesve civilë, dhe provoja e punës paguhet dhe e kemi nda si kod të veçantë nëse e analizojmë ajo shume hynë në pagesë bruto, janë tatimet, trusti. Raporti i auditimit për vitin 2023 është në proces ende nuk e kemi pranuar si draft, deri në javën paraprake kanë qenë në auditim zyra kombëtare e auditorit, presim shpejt te kemi draftin dhe pastaj raportin final.

Kryesuesja; Fjalën ja kaloj;

Drejtorit DKA-së, Kastriot Duraku: Fjala përshëndetëse, desha të ndërlidhem të shpenzimi për dru, realisht kjo kontratë për dru është kontratë e vitit të kaluar, si në komunat tjera edhe në komunën ton çmimi i druve ka pas dyfishim të ngritjes së çmimit, është borxh i vitit të kaluar që është bart këtë vite.

Kryesuesja; Dikush tjetër, nëse nuk ka, konstatojmë me (16) vota për, (8) kundër dhe (2) abstenim përkrah Shqyrtimi i raportit financiar tremujore, Janar-Mars 2024, me Nr. 02-052/01-0018545/24, të datës 15.04.2024.

Vazhdojmë me piken 5 të rendit të ditës:

-Informatë lidhur me bursat për studentë, për vitin shkollor 2023/2024, nga Drejtoria e Arsimit, me Nr.07-670/01-0018899/24, të datës 16.04.2024, (Raporton);

Drejtori DKA-së, Kastriot Duraku; Para jush e keni, Informatë lidhur me bursat për studentë, për vitin shkollor 2023/2024, nga Drejtoria e Arsimit, Komuna e Skenderajt me datën 13.12.2023 ka shpallur konkurse për ndarjen e bursave për këtë konkurse janë pranuar 402 aplikacione, që është i bashkangjitur konkursi bashkë me listën e përfituesve. Komisioni pas rezultatit, ka pranuar mbi 50 ankesa, shumica e ankesave kanë qenë të përfituesve të emrave të dyfishtë, pasi që kriter ka qenë, që përfituesit të mos jenë përfitues të bursave në nivel qendrorë të MASHIT, UP, apo të ndonjë institucioni relevant të cilët shpërndajnë bursa, komisioni ka analizuar, dhe 15 student përfitues kanë qenë në listën e MASH-it, dhe me vendim janë larguar dhe përfitues përfundimtar janë 116 student të drejtimeve të ndryshme.

Kryesuesja: E hap debatin, fjalën ja kaloj;

Abdulla Gashi-IDEAL: Fjala përshëndetëse, Pyetje për drejtorin e DKA-se Kastriot Duraku: Drejtor, a ke mundësi me na sqarua çështjen e dhënies se bursave për studentet, A i keni bere vlerësimet e drejta te përfitueseve te bursave? Drejtor, me çfarë vlerësimi iu keni dhëne bursa studenteve te disa familjeve te cilat janë ne gjendje te japin vet bursa e jo te jene përfitues te tyre. Siç e dimë ne, e dini edhe ju se iu keni dhënë bursa edhe dy studenteve te se njejtës familje, ajo familje është përfituese nga komuna e ju i keni shpërblye edhe me bursa. Fale ankesave te mëdha qe janë bere nga studentet, jeni mundu me reflektua dhe keni bere disa ndryshime te vogla. Sa i përket transparencës, keni 0 transparence. Merrni mësim nga komunat tjera e te jeni me transparentë! Çka është kjo liste emri, mbiemri drejtimi dhe numri total i pikëve. Shiko si duhet te jete transparenca: emri, emri i prindit, mbiemri, fakulteti, drejtimi, nota mesatare, vërtetim dhe dokumente përcjellëse, niveli i studentit, piket ne baze te kriterëve dhe numri total i pikëve. Ju lutem reflektoni! Drejtor, si ka mundësi me hy drejtoresha ne ore te mësimit me ia rrahe tavolinën mësimdhënësit para nxënësve, kjo është e turpshme? A keni ndërmarre ndonjë veprim për këtë skandal qe ka ndodhur muaj me pare ne gjimnazin "Hamez Jashari". A ka pasur ankesë nga ana e mësimdhënësit dhe nëse ka pasur a e keni shqyrtuar këtë ankesë.

Liridona Koci-PDK: Fjala përshëndetëse, e kam përcjell çështjen e bursave për student, me vjen mirë që i keni evidentuar gabimet së gjithkujt mundet me i ndodh, po mua me intereson çështja e studenteve të ankesave që u përmenden që 15 student janë larguar nga lista çka është bërë me studentet e ankesave a janë zëvendësuar dhe a mundeni ti bëni publik emrat e tyre?

Hysni Mehani-LVV: Drejtor do situata nuk mundem me i tejkalua përveç asaj çka tha Abdullahi së është veç emri dhe mbiemri, nëse po donë transparencë duhet emrin, mbiemrin, fshatin, po kjo është një mundësi me na m' shef, po ajo çka është në letra tregon së çka është punua, ty me një kriter ti ka qitë jashtë 15 studentë, po me pas fillua me hetua edhe sipas kriterëve tjera çka kish ndodh, në anën tjetër ky nuk është lëshim teknik, ky është shkelje procedurale, mos respektim i detyrës, lëshim teknik është me qitë një pik, një presje, diçka që ndodh nga pakujdesia po ky ka qenë kriter, është papërgjegjësi e për këtë dikush është dashur me shkua në përgjegjësi e së pari është kanë dashur me shkua ti.

Naser Bajraktari-IDEAL: Fjala përshëndetëse, drejtor pse nuk i keni publikua emrat e atyre studenteve që nuk janë përfitues të bursave, dhe me cek që për këtë arsye nuk i ka plotësua kriteret?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj;

Drejtori DKA-së, Kastriot Duraku; Realisht zëvendësimin e 15 studenteve nuk e kemi bërë, pasi që kanë qenë 100 bursa të shpallura në konkurse, po për shkak të numrit të barabarta të pikëve ne i kemi shpërndarë 116 bursa, shumica kanë qenë drejtime të fakultetit të mjekësisë, mirëpo janë larguar 15 janë mbetur 101 student. Sa i përket të dhënave shpesh për student, se di a e keni pa listën e komunave tjera apo të MASH-it, as emri nuk i figuron veç numri i kërkesës pikët dhe fakulteti, ju nëse doni mundeni me ardhur në zyre e me i pa për së cilin student lenden, dhe listën, vitin tjetër nëse done mundesh ma ardhur ne komision Abdulla, e me shikua qysh po ec procesi i bursave.

Kryesuesja: dikush tjetër, nëse nuk ka, konstatojmë me (17) vota për, (7) kundër dhe (1) abstenim përkratet Informatë lidhur me bursat për studentë, për vitin shkollor 2023/2024, nga Drejtorja e Arsimit, me Nr.07-670/01-0018899/24, të datës 16.04.2024.

Vazhdojmë me piken 6 të rendit të ditës:

-Informatë mbi gjendjen e banimit social në komunën e Skenderajt në periudhën Janar-2023, Mars-2024, me Nr.08-360/01-0019827/24, të datës 22.04.2024, (Raporton);

Drejtoresha e DShMS-së, Rrezarta Hasani-Ibrahimi; Fjala përshëndetëse, para jush është Informata mbi gjendjen e banimit social në komunën e Skenderajt në periudhën Janar-2023, Mars-2024, Komuna e Skenderajt kërkesave të qytetarëve rreth çështjeve së strehimit ju del në ndihmë në disa forma si; Banesa sociale, ndërtim të shtëpive, renovim të shtëpive dhe pagës të qeras. Komuna ka në pronësi tri objekte të banimit social me gjithsej 100 njësi të banimi. Objekti nr.1 janë të strehuar 26 familje, objekti nr.2 janë strehuar 25 familje dhe objekti nr.3 janë të strehuar 49 familje. Gjatë kësaj periudhë i kemi këto kërkesa në Banesa sociale 28 kërkesa të reja, 10 prej tyre janë vendosur në banesa pas lirimit nga shfrytëzuesi e mëparshëm. Ndërtim të shtëpive i kemi 18 kërkesa, prej tyre 2 janë përfunduar me bashkëpunim me shoqatën humanitare Bereqeti dhe Islamik Reliefi Kosova. Renovim të shtëpive i kemi 35 kërkesa, prej tyre 16 prej tyre janë ndihmuar nga subvencionet e drejtorisë. Dhe pagesa me qeras kemi 15 kërkesa nga këto 7 prej tyre janë ndihmuar, si dhe 3 familje që kanë qenë raste të dhunës së familjes janë ndihmuar. Nga janari i vitit 2024 rastet me asistencë sociale kanë rënë në 692 raste. Vlen të ceket së komuna e Skenderajt është përfituese e grantit nga fondi i Kosovës për eficiencë dhe energji për renovimin e tri objekteve të banimit social vlera e përgjithshme është 700 mijë €, dhe pritet shume shpejtë të filloj.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj;

Ali Lutfiu-PDK: Fjala përshëndetëse, po e shohë një ndryshim të rënjes të familjeve me asistencë sociale, desha të lidhem një praktik me të lehtë të rregullimit të dokumentacioneve për asistencë

sociale, që është praktik që përmes mjekut rregullojnë dokumentet, që mjeki me përcaktua gjendjen ekonomike të familjes që janë me asistencë sociale, që për mendimin tim është një gabim, ndoshta kjo është e rregulluar me ligj po desha një sqarim, a ka mundësi që përmes një komisioni me përcaktua gjendjen ekonomike të familjes që marrin asistencë sociale, ku dihet që mjeki e përcakton gjendjen fizike të pensionit invalidor e jo kush me marr asistencë sociale.

Afrim Kabashi-NSD: Drejtoresh a ka banorë në banesa sociale që e kanë të rregulluar çështjen e banimit, nëse e dimë që ka dhe ende banojnë në banesa sociale, a keni ndërmarr masa ndaj atyre banorëve?

Hysni Mehani-LVV: Drejtoresh a keni aplikua si komunë për banim të përballueshëm, ju e dini së z.Nura nuk dojke me aplikua për thirrje që e ka pas ministria e infrastrukturës po sot i ka nënshkruar afër 500 mijë €, si mbështetje nga ministria e infrastrukturës, pra ju a keni aplikua për banim të përballueshëm si komunë së besoj që është në kuadër të drejtorisë të juaj që e udhëheqë, edhe kjo çka po thotë z.Aliu 120 familje me pak me asistencë sociale a ka ndonjë analizë pse është kjo renje, a është përmisua gjendja ekonomike apo janë kriteret ma strikte, çka ka ndryshua?

Abdulla Gashi-IDEAL: Drejtoresh, sa i përket banesave sociale a i ke shikuar a i ke evidentuar, së ka disa familje aty e kanë të rregulluar çështjen e banimit, kanë edhe paga të majme dhe banojnë në banesa sociale, a keni ndërmarr diçka në këtë aspekt?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Drejtoresha e DShMS-së, Rrezarta Hasani-Ibrahimi; Forma e kërkesës për asistencë sociale është përpiluar nga ministria nuk mundem me ndryshua, i kemi 9 familje të vendosura pa kontratë ju kemi dërgua vërejtje jemi munduar në mënyra të ndryshme me i largua po nuk kanë pranuar të largohen, tash në shtator skadon kontrata, dhe së cila familje ka kontratë dy vjeçare, prapë kemi me ju dërgua vërejtje, ka disa familje që e kanë liruuar. Nuk kemi aplikuar së aty ka qenë kriter me ndërtua një objekt të ri të banimit social dhe nëse nuk e kemi në planë një herë me ndërtua. Arsyeja e zbritjes të numrit të familjeve me asistencë sociale është për shkak të largimit nga vendi së kurrë ma keq nuk ka qenë gjendja ekonomike.

Kryesuesja: Replikë 1 min.

Hysni Mehani-LVV: Po thua së aty ka pas me ndërtua një banesë sociale, kush ka pas me ndërtua, dhe a po kupton për çka po të pyesë, për banim të përballueshëm kush ka pas me ndërtua atë?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Kryetari i Komunës, Fadil Nura: Sot e kemi nënshkruar një marrëveshje me ministrin e infrastrukturës, jo me thirrje, po me kërkesë, thirrjet që i bënë ministria nuk mundem me kanë për bashkëpunim, e sot nënshkruam marrëveshje për ndërtimin e urave dhe një projekti të rrugëve me kërkesë.

Kryesuesja: Dikush tjetër, nëse nuk ka, Konstatojmë me (17) vota për, (9) kundër dhe (0) abstenim përkrah të Informatë mbi gjendjen e banimit social në komunën e Skenderajt në periudhën Janar-2023, Mars-2024, me Nr.08-360/01-0019827/24, të datës 22.04.2024.

Vazhdojmë me piken 7 të rendit të ditës:

-Pyetjet e këshilltarëve nën piken të ndryshme, fjalën ja kaloj:

Abdulla Gashi-IDEAL: Për pyetjen e parë kam marr përgjigje, 2.Pyetje për drejtoreshën e shëndetësisë znj. Rrezarta Ibrahimi: Drejtoreshë, a ka mundësi me u përgjigje rreth konkursit për 10 pozita infermiere në QKMF, çka ka ndodhe, pse nuk e vazhduat deri në fund procesin e konkursit, pse e keni anuluar konkursin?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Drejtoresha e DShMS-së, Rrezarta Hasani-Ibrahimi; Konkursi që është shpallur është anuluar për arsye së kryetari i komisionit ka pas probleme shëndetësore dhe ka kërkuar pushim mjekësor dhe kanë ecur afatet, dhe shume shpejtë do te ri-shpallëm konkursi për infermierë.

Kryesuesja, Fjalën ja kaloj:

Besiana Thaçi-PDK: Fjala përshëndetëse, Kryetar, ujësjellësi në fshatin Burojë cili është plani për këtë vite kur pritet me përfundua ky projekte pasi që është edhe kërkesë e banorëve të fshatit Burojë që me përfundua sa ma shpejtë?

Kryesuesja, Fjalën ja kaloj:

Kryetari i Komunës, Fadil Nura: Është një prej projekteve që e kemi me më prioritet jemi në kontakt me kompaninë e ujësjellësit që për 90 shtëpi me ja vendos orët dhe pastaj vazhdojmë me pjesët tjera dhe besoj gjatë verës fshati Burojë ka me qenë i furnizuar me ujë.


Kryesuesja; Faleminderit, dikush tjetër, nëse nuk ka, me kaq mbyllet ky takimi, shihemi në mbledhjen tjetër.

Procesmbajtësi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Precednika / Office of the Mayor

Në bazë të nenit 58 shkronja h), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 50 shkronja h), të Statutit të Komunës së Skenderajt 01Nr.110-385 të dt.03.12.2008, sipas nenit 50 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe kërkesës së MAPL-së Nr.020-254/9 të datës 13.05.2024, Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës, në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2024, Kryetari i Komunës i:

PROPOZON

- Rishqyrtimin e Vendimit Nr.01-020/01-0016897/24 të datës 03.04.2024 për themelimin e komisionit të Kuvendit të Komunës për zgjedhjen e Këshillave Lokale, të harmonizuar konform nenit 5 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.02-2019, lidhur me përbërjen e komisionit tek anëtarët e Kuvendit të Komunës të cilët duhet të jenë nga subjektet të ndryshme politike, që nënkupton anëtarë nga secili subjekt politik të përfaqësuar në Kuvendin e Komunës së Skenderajt.**
- Sipas pikës 1 të këtij propozimi komisioni do të këtë përbërjen si vijon: 4 (katër) anëtar nga kuvendi i komunës nga subjektet të ndryshme politike, (që nënkupton anëtarë nga secili subjekt politik), 1 (një) anëtar nga ekzekutivi, 1 (një) anëtar nga Shoqëria civile dhe 1 (një) përfaqësues nga fshati, vendbanimi apo lagja urbane nga lokaliteti ku bëhet zgjedhja e këshillit lokal.
- Ky propozim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

ARSYETIM

Kryetari i Komunës së Skenderajt me datën 13.03.2024 ka dërguar propozimin vendimin nr.02-020/01-0013528/24 për miratim në Kuvendin e Komunës lidhur me themelimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale, konform nenit 5 paragrafi 2 të UA nr.02-2019, ndërsa me datën 28.03.2024 Kuvendi i Komunës e ka miratuar propozim-vendimin për themelimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale duke i'u dhënë mundësin secilit subjekt politik të bëhen anëtarë në këtë komision, mirëpo të njëjtit nuk kanë shpreh interesimin për të hyrë në këtë komision, andaj komisioni u themelua në përbërje vetëm nga dy subjekte politike, e që pas vlerësimit të Ligjshmërisë nga MAPL-ja, me datë 04.04.2024, e njëjta ka sugjeruar së sipas nenit 5 paragrafi 2 të UA nr.02-2019, komisioni duhet të këtë përbërje nga secili subjekt politik, ashtuqë konform kërkesës së MAPL-së dhe legjislacionit në fuqi, kryetari i komunës edhe njëherë i propozon kuvendit të komunës miratimin e Vendimit për themelimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale të harmonizuar me legjislacionin në fuqi, i cili do të këtë përbërjen 4 (katër) anëtar nga kuvendi i komunës nga subjektet të ndryshme politike, (që nënkupton anëtarë nga secili subjekt politik), 1 (një) anëtar nga ekzekutivi, 1 (një) anëtar nga Shoqëria civile dhe 1 (një) përfaqësues nga fshati, vendbanimi apo lagja urbane nga lokaliteti ku bëhet zgjedhja e këshillit lokal.

Bashkëngjitur: Kërkesa e Ministrisë Nr.020-254/9 të datës 13.05.2024 dhe Vendimi Nr.02-020/01-0013


Propozimi i'u dërgohet:

- Arkivit
- Kryesueses së KK-së



Kryetari i Komunës

Fadil Nura



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për :	Fadil Nura, Kryetar i Komunës së Skenderajt Adelina Spahiu, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Skenderajt	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, U.D. Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së	
Nga:	Erblin Hetemi, U.D. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL	Date: 18/04 /2024
Zyrtarët përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit të Monitorimit Driton Xhafa, Zyrtar për Monitorimin e Komunave	Nr. 020-254
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor		
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor		
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtim të ligjshmërisë së aktit të komunës së Skenderajt	
Lloji i aktit:	Vendimit	

I nderuar Kryetar,
E nderuara Kryesuese,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshim-plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim nr. 01-020/01-0016897/24 për themelimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale
I miratuar në komunë me datë : 28.03.2024
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 04.04.2024

Ministria e Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson së akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e mbajtur me datën 28.03.2024 ka miratuar Vendim nr. 01-020/01-0016897/24 për themelimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale.

MAPL konstaton, se nxjerrja e Vendimit 01-020/01-0016897/24 neni dy (2) që përcakton "Përbërjen e komisionit" nuk e përmbushë kriterin bazë të përcaktuar në nenin 5 paragrafit 2 të Udhëzimit Administrativ nr. 02-2019 për Organizimin, Funkcionimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatra, Lagjet dhe Vendbanimet Urbane.

Udhëzimit Administrativ nr. 02-2019 në nenin 5 paragrafit 2 ka përcaktuar se "Komisioni duhet të ketë shtatë (7) anëtarë. Përbërja duhet të jetë katër (4) anëtarë nga kuvendi i komunës nga subjekte të ndryshme politike, një (1) anëtar nga ekzekutivi, një (1) nga shoqëria civile dhe një (1) përfaqësues nga fshati, vendbanimi apo lagja urbane nga lokaliteti ku bëhet zgjedhja e këshillit lokal" që në rastin konkret anëtarët nga kuvendi i komunës së Skenderajt nuk janë të përfaqësuar nga subjekte të ndryshme politike ashtu si janë të përfaqësuar në kuvend.

Në Kuvendin e Komunës së Skenderajt janë të përfaqësuar pesë (5) etnitete politike ndërsa në Vendim nr. 01-020/01-0016897/24 janë të përfshirë vetëm dy etnitete politike dhe kjo ka pamundësuar përfaqësimin e duhur në komisionin për koordinimin e zgjedhjeve të këshillave lokale.

Bazuar në të lartcekurat Kuvendi i Komunës së Kamenicës duhet të ndërmerr veprime dhe brenda afatit ligjor të rishqyrtoj aktin dhe të harmonizoj më legjislacionin në fuqi.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



03.04.2024



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipal Assembly

Në bazë të nenit 11, nenin 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), dhe neni 40 par. 1 dhe 2 shkronja e) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, neni 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2019 për Organizimin, Funkcionimin dhe bashkëpunimin e Komunave me Fshatra, Vëndbanime dhe Lagjet Urbane, dhe Rregullorja Nr.01-110/01-0047005/20 për Organizimin, Funkcionimin dhe bashkëpunimin e Komunave me Fshatra, Vëndbanime dhe Lagjet Urbane të Komunës së Skenderajt, dhe neni 14 par. 1 dhe 2 shkronja d) të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, i dt.03.12.2008, Kuvendi i Komunës së Skenderajt, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 28.03.2024 miratoi këtë:

V E N D I M

(Për themelimin e komisionit të Kuvendit të Komunës për zgjedhjen e Këshillave Lokale)

Neni 1

Miratohet propozimi-vendim më Nr.02-020/01-0013528/24, i datës 13.03.2024, Për themelimin e komisionit të Kuvendit të Komunës për zgjedhjen e Këshillave Lokale.

Neni 2

Sipas nenit 1 të këtij vendimi komisionit ka këtë përbërje si në vijim:

1. Ilmi Kabashi - anëtarë nga ekzekutivi, PDK
2. Liridona Koci - anëtare nga legjislativi, PDK
3. Fikret Rexhepi - anëtar nga legjislativi, PDK
4. Besiana Thaqi - anëtare nga legjislativi, PDK
5. Abdulla Gashi - anëtar nga legjislativi, LISTA E RAVALOR
6. Milazim Mustafa - anëtar nga shoqëria civile,
7. _____ anëtar nga lokaliteti (fshatë, vëndbanim apo lagje).

HYRËSE - HAZINA - HOCUMING		
Shkurtorja e Administratës të Preshevit Lokal		
Shkurtojshka - Local Government Administration		
Date: 04.04.2024		
Gjatë:		
Numri i dokumentit	Nr. i vendit	Gjatë
41	010-234	

Neni 3

Detyrat e komisionit është që të bëjë koordinimin e procesit të zgjedhjes së Këshillave Lokale dhe për punën e tij i raporton Kuvendit Komunal.

Neni 4

Mandati i komisionit është i lidhur me mandatin e kuvendit të komunës.

Neni 5

Zbatimin e këtij vendimi do ta bëjë: Anëtarët e Komisionit, nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komunës.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së, si dhe publikimit të tij në ueb - faqen e Komunës.

Vendimi i Dërgohet :

- 1x1 Arkivit,
- 1x1 Zyrës së Kryetarit .
- 1x1 Anëtarëve të komisionit,
- 1x1 MAPL-së,
- 1x1 Dosjes.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPSTINA OPŠTINE
SKENDERAJ

Nr.
No. 09-020/01-0016897/24
Data
Date 03-04-2024



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupstina Opštine/Municipal Assembly

Në bazë të nenit 11, nenin 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), dhe neni 40 par. 1 dhe 2 shkronja e) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, neni 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2019 për Organizimin, Funksonimin dhe bashkëpunimin e Komunave me Fshatra, Vendbanime dhe Lagjet Urbane, dhe Rregullorja Nr.01-110/01-0047005/20 për Organizimin, Funksonimin dhe bashkëpunimin e Komunave me Fshatra, Vendbanime dhe Lagjet Urbane të Komunës së Skenderajt, dhe neni 14 par. 1 dhe 2 shkronja d) të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, i dt.03.12.2008, Kuvendi i Komunës së Skenderajt, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 28.03.2024 miratoi këtë:

V E N D I M

(Për themelimin e komisionit të Kuvendit të Komunës për zgjedhjen e Këshillave Lokale)

Neni 1

Miratohet propozimi-vendim më Nr.02-020/01-0013528/24, i datës 13.03.2024, Për themelimin e komisionit të Kuvendit të Komunës për zgjedhjen e Këshillave Lokale.

Neni 2

Sipas nenit 1 të këtij vendimi komisionit ka këtë përbërje si në vijim:

1. **Ilmi Kabashi** - anëtarë nga ekzekutivi,
2. **Liridona Koci** - anëtare nga legjislativi,
3. **Fikret Rexhepi** - anëtar nga legjislativi,
4. **Besiana Thaqi** - anëtare nga legjislativi,
5. **Abdulla Gashi** - anëtar nga legjislativi,
6. **Milazim Mustafa** - anëtar nga shoqëria civile,
7. _____ anëtar nga lokaliteti (fshatë, vendbanim apo lagje).

Neni 3

Detyrat e komisionit është që të bëjë koordinimin e procesit të zgjedhjes së Këshillave Lokale dhe për punën e tij i raporton Kuvendit Komunal.

Neni 4

Mandati i komisionit është i lidhur me mandatin e kuvendit të komunës.

Neni 5

Zbatimin e këtij vendimi do ta bëjë: Anëtarët e Komisionit, nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komunës.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së, si dhe publikimit të tij në ueb - faqen e Komunës.

Vendimi i Dërgohet :

- 1x1 Arkivit,
- 1x1 Zyrës së Kryetarit .
- 1x1 Anëtarëve të komisionit,
- 1x1 MAPL-së,
- 1x1 Dosjes.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINE
SKENDERAJ

Nr.
No. 02-020/01-0023066/24
Data
Date 15-05-2024



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Kryetari i Komunës së Skenderajt në bazë të dispozitave ligjore, nenit 58, shkronja h) nderlidhur me nenin 12 paragrafi 12.1 dhe 12.2 shkronja d), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 53, nenit 57 parag.1 dhe nenit 58 parag.2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 50 parag. 50.1 shkronja h) të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385 të datës 03.12.2008, dhe pas shqyrtimit të kërkesës Nr.2371-2/24 të datës 30.04.2024 të MMPHI-së, Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me _____ 2024 i:

PROPOZON

- I. Të Shfuqizohet në tërësi Vendimi Nr.01-020/01-0016899/24 të datës 03.04.2024, me të cilin është formuar komisioni për ndarjen e banesave për Familjet (të ngushtë) të Dëshmorëve të UÇK-së, i miratuar në Kuvendin e Komunës së Skenderajt me datën 28.03.2024.
- II. Vendimi i lartcekur propozohet të shfuqizohet me arsyetimin së pas vlerësimit të ligjshmërisë nga MMPHI-ja, e cila me kërkesën nr.2371-2/24 të datës 30.04.2024 ka kërkuar që vendimi Nr.01-020/01-0016899/24 i Komunës të harmonizohet me Ligjin Nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit dhe Udhëzimeve Administrative që derivojnë nga ky Ligj, gjë që kjo çështje nuk ndërlidhet me këtë ligj përkitazi me vendimin për formimin e komisionit për ndarjen e banesave për Familjet (të ngushta) të Dëshmorëve të UÇK-së, andaj duke u bazuar në legjislacionin në fuqi, Komuna e Skenderajt lidhur me këtë çështje do të zhvilloj procedura tjera sipas legjislacionit në fuqi.
- III. Ky propozim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

Bashkangjitur: Kërkesa nr. 2371-2/24 të datës 30.04.2024 dhe Vendimi i Kuvendit të Komunës Nr.01-020/01-0016899/24 të datës 03.04.2024.

Propozimi i dërgohet:

- Arkivit
- Kryesueses së KK-së



Kryetari i Komunës

Fadil Nura



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTRIE E MËDITIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Në cilin org. Org. Jeshtra Org. Urit	06
Nr. i Fajdes Pr. Struktura Na. Pajon	-02-
Nr. i Posa. Brid. Posa. Fytr. Posa.	2371-2/24
Data Dhimitri Data	30.03.24
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Për:	Fadil Nura, Kryetar i Komunës së Skenderaj Adelina Spahiu, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Skenderaj
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL Jeton Qela, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër i MMPHI Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës:	
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit komunal
Lloji i aktit:	Vendimi Nr. 01-020/01-0016899/24 për formimin e komisionit për ndarjen e banesave për Familjet (të ngushtë) të Dëshmorëve të Uçk-së, datë 28.03.2024

Nr. VL 87/24
Date: 22.04.2024

I nderuar kryetar Nura,
E nderuar kryesuese Spahiu

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave ka pranuar nga MAPL Vendimin Nr. 01-020/01-0016899/24 për formimin e komisionit për ndarjen e banesave për Familjet (të ngushtë) të Dëshmorëve të Uçk-së, miratuar nga Kuvendi Komunal i Skenderajt, datë 28.03.2024.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave kërkon nga Kuvendi Komunal i Skenderajt:

RISHQYRTIMIN E LIGJSHMËRISË SË AKTIT

Vendimin Nr. 01-020/01-0016899/24 për formimin e komisionit për ndarjen e banesave për Familjet (të ngushtë) të Dëshmorëve të Uçk-së, miratuar nga Kuvendi Komunal i Skenderajt, datë 28.03.2024.

ARSYETIMI


Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të vendimit të sipërsënuar konstatoi se:

Vendimin Nr. 01-020/01-0016899/24 për formimin e komisionit për ndarjen e banesave për Familjet (të ngushtë) të Dëshmorëve të Uçk-së duhet të harmonizohet me Ligjin Nr. 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit dhe Udhëzimet Administrative që derivojnë nga ky Ligj.

Të vepohet sipas vlerësimit të ligjshmërisë së aktit komunal nga MMPHI, të merr vendim të drejtë dhe të ligjshëm në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, jo më vonë se afati i paraparë në dispozitat e nenit 9 të Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave i ndryshuar dhe i plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINE
SKENDERAJ

Nr.
No. 01-020/01-0016899/24
Data
Date 03-04-2024



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipal Assembly

Në bazë të nenit 11, nenin 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), dhe neni 40 par. 1 dhe 2 shkronja e) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, , dhe neni 14 par. 1 dhe 2 shkronja d) të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, i dt.03.12.2008, Kuvendi i Komunës së Skenderajt, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 28.03.2024 miratoi këtë:

V E N D I M

(Për formimin e komisionit për ndarjen e banesave për Familjet (të ngushta) e Dëshmorëve të UÇK-së)

Neni 1

Miratohet propozimi-vendim më Nr.02-020/01-0013489/24, i datës 12.03.2024, Për formimin e komisionit për ndarjen e banesave për Familjet (të ngushta) e Dëshmorëve të UÇK-së.

Neni 2

Sipas nenit 1 të këtij vendimi komisionit ka këtë përbërje si në vijim:

1. **Albinot Mehmeti** - anëtar nga ekzekutivi (DSHMS),
2. **Miradije Buliqi** - anëtare nga legjislativi,
3. **Besiana Thaçi** - anëtare nga legjislativi,
4. **Musa Fazliu** - anëtar nga legjislativi,
5. **Brahim Misimi** - anëtar nga shoqëria civile (ShFD e UÇK-së).

Neni 3

Detyrat e komisionit është që të bëjë shpalljen e thirrjes publike, shqyrtimin e aplikacioneve, përzgjedhjen e përfutuesve sipas kritereve të përcaktuara në thirrje, si dhe propozimin e për miratim në Kuvendin Komunal.

Neni 4

Zbatimin e këtij vendimi do ta bëjë: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, dhe Anëtarët e Komisionit, nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komunës.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së, si dhe publikimit të tij në ueb – faqen e Komunës.

Vendimi i Dërgohet :

- 1x1 Arkivit,
- 1x1 Zyrës së Kryetarit,
- 1x1 DSHMS-së,
- 1x1 Anëtarëve të komisionit,
- 1x1 MAPL-së,
- 1x1 Dosjes.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E SKENDERAJ
SHKENDRAJ

Nr.
No. 2020/01-00 23061/24
Data,
Data 25.05.2024



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Kryetari i Komunës së Skenderajt në bazë të dispozitave ligjore, nenit 58, shkronja h) nderlidhur me nenin 12 paragrafi 12.1 dhe 12.2 shkronja d), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 53, nenit 57 parag.1 dhe nenit 58 parag.2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 50 parag. 50.1 shkronja h) të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385 të datës 03.12.2008, dhe pas shqyrtimit të kërkesës Nr.2370-2/24 të datës 30.04.2024 të MMPHI-së, Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me _____ 2024 i:

PROPOZON

- I. Të Shfuqizohet në tërësi Vendimi Nr.01-020/01-0016898/24 të datës 03.04.2024, me të cilin është themeluar komisioni për shqyrtimin e ankesave përkitazi me ndarjen e banesave për Familjet e Dëshmorëve të UÇK-së, i miratuar në Kuvendin e Komunës së Skenderajt me datën 28.03.2024.
- II. Vendimi i lartcekur propozohet të shfuqizohet me arsyetimin së pas vlerësimit të ligjshmërisë nga MMPHI-ja, e cila me kërkesën nr.2370-2/24 të datës 30.04.2024 ka kërkuar që vendimi Nr.01-020/01-0016898/24 i Komunës të harmonizohet me Ligjin Nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit dhe Udhëzimeve Administrative që derivojnë nga ky Ligj, gjë që kjo çështje nuk ndërlihet me këtë ligj përkitazi me vendimin për themelimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave përkitazi me ndarjen e banesave për Familjet të Dëshmorëve të UÇK-së, andaj duke u bazuar në legjislacionin në fuqi, Komuna e Skenderajt lidhur me këtë çështje do të zhvilloj procedura tjera sipas legjislacionit në fuqi.
- III. Ky propozim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

Bashkangjitur: Kërkesa nr. 2370-2/24 të datës 30.04.2024 dhe Vendimi i Kuvendit të Komunës Nr.01-020/01-0016898/24 të datës 03.04.2024.

Propozimi i dërgohet:

- Arkivit
- Kryesueses së KK-së



Kryetari i Komunës

Fadil Nura



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTRARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia nr./ Org./Instit. Org./Unit	Ac
Nr./Tëpër. Bil. Shprehje No/Expr.	-02-
Nr. Llogar. Urdh. Posa. Doc. No.	2370-2/26
Titulli Datimi Date	30.03.24
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Për:	Fadil Nura, Kryetar i Komunës së Skenderaj Adelina Spahiu, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Skenderaj
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL Jeton Qela, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër i MMPHI Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor Nr. VL-86/24
Zyrtarët përgjegjës:	Datë: 22.04.2024
1. Zyrtari i konfirmues i vlerësimit ligjor	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit komunal
Lloji i aktit:	Vendimi Nr. 01-020/01-0016898/24 për themelimin e komisionit të kuvendit të komunës për shqyrtimin e ankesave përkitazi me ndarjen e banesave për Familjet (të ngushtë) të Dëshmorëve të Uçk-së, miratuar nga Kuvendi Komunal i Skenderajt, datë 28.03.2024

I nderuar kryetar Nura,
E nderuar kryesuese Spahiu

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave ka pranuar nga MAPL Vendimin Nr. 01-020/01-0016898/24 për themelimin e komisionit të kuvendit të komunës për shqyrtimin e ankesave përkitazi me ndarjen e banesave për Familjet (të ngushtë) të Dëshmorëve të Uçk-së, miratuar nga Kuvendi Komunal i Skenderajt, datë 28.03.2024.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave kërkon nga Kuvendi Komunal i Skenderajt:

RISHQYRTIMIN E LIGJSHMËRISË SË AKTIT

Vendimin Nr. 01-020/01-0016898/24 për themelimin e komisionit të kuvendit të komunës për shqyrtimin e ankesave përkitazi me ndarjen e banesave për Familjet (të ngushtë) të Dëshmorëve të UÇK-së, miratuar nga Kuvendi Komunal i Skenderajt, datë 28.03.2024.

ARSYETIMI

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të vendimit të sipërshënuar konstatoi se:

Vendimi Nr. 01-020/01-0016899/24 për formimin e komisionit për ndarjen e banesave për Familjet (të ngushtë) të Dëshmorëve të UÇK-së duhet të harmonizohet me Ligjin Nr. 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit dhe Udhëzimet Administrative që derivojnë nga ky Ligj.

Të veprohet sipas vlerësimit të ligjshmërisë së aktit komunal nga MMPHI, të merr vendim të drejtë dhe të ligjshëm në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, jo më vonë se afati i paraparë në dispozitat e nenit 9tw Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave i ndryshuar dhe i plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPSTINA OPSTINE
SKENDERAJ

Nr
No 01-020/01-0016898/24
Data
Date 03-04-2024



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupstina Opstine/Municipal Assambly

Në bazë të nenit 11, nenin 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), dhe neni 40 par. 1 dhe 2 shkronja e) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, , dhe neni 14 par. 1 dhe 2 shkronja d) të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, i dt.03.12.2008, Kuvendi i Komunës së Skenderajt, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 28.03.2024 miratoi këtë:

V E N D I M

(Për themelimin e komisionit të kuvendit të komunës për shqyrtimin e ankesave përkitazi me ndarjen e banesave për Familjet e Dëshmorëve të UÇK-ës)

Neni 1

Miratohet propozimi-vendim më Nr.02-020/01-0013678/24, i datës 13.03.2024, Për themelimin e komisionit të kuvendit të komunës për shqyrtimin e ankesave përkitazi me ndarjen e banesave për Familjet e Dëshmorëve të UÇK-ës.

Neni 2

Sipas nenit 1 të këtij vendimi komisionit ka këtë përbërje si në vijim:

1. **Besart Rrecaj** - anëtar nga legjislativi,
2. **Ferdane Beqiri-Emini** - anëtare nga legjislativi,
3. **Osman Smajli** - anëtar nga legjislativi,
4. **Selim Tahiri** - anëtar nga legjislativi,
5. **Hysni Mehani** - anëtar nga legjislativi.

Neni 3

Detyrat e komisionit është që të bëjë shqyrtimin e të gjitha ankesave dhe brenda afatit prej 15 ditësh nga data e parashtrimit të ankesës, t'u kthej përgjigje me shkrim parashtruesve të ankesave, si dhe për punën e tij t'i raportoj Kuvendit të Komunës.

Neni 4

Në zonën prej VI shkallë të Rihterit bënë pjesë 5/6 e sipërfaqes së përgjithshme të komunës në përgjithësi, kryesisht pjesa përendimore e komunës. Në zonën prej VII shkallë të Rihterit bënë pjesë 1/6 e sipërfaqes së përgjithshme të komunës kryesisht pjesa lindore e komunës. Në bazë të karakteristikave gjeodezike dhe karkteristikave të zonës sizmike të Skënderajt paraqet një mesatare të dridhjeve sizmike.

Karakteristikat pedologjike - Komuna e Skënderajt shtrihet në terrenin me përbërje të llojllojshme pedologjike. Në bazë të shënimeve nga Plani Urbanistik i vitit 1974 shihet se territori i ngushtë i qendrës së qytetit ka një përbërje ranore, me prezencën e karbonateve, aluvininë, ndërsa në pjesët tjera të terrenit të komunës përbërja e tokës është humusore dhe smonicë. Kualiteti i tokës varion nga toka e klasit të I-rë deri te toka e klasit të V-të.

Kategoritë e tokës- Sipas shënimeve kadastrale dhe studimeve të mëhershme, toka e komunës përfshihet në kategoritë I deri në VI si dhe tokën e pakategorizuar jopjellore (tokë shterrpë). Një pjesë shumë e vogël me afro 10 % të sipërfaqes së gjithëmbarshme bënë pjesë në kategorinë e II dhe të I, ndërsa pjesa dërmuese bënë pjesë në kat. e V dhe të VI.

Pasuritë natyrore të komunës- Territori i komunës së Skënderajt në pikëpamje gjeologjike nuk është hulumtuar mjaft, kështu që janë të nevojshme hulumtimet e mëtejshme në këtë drejtim. Territori që përfshin komuna e Skënderajt nuk ka hulumtime të mjaftueshme nga aspekti gjeologjik, andaj të dhënat që do t'i japim me sa vijon nuk janë të gjitha të dhënat për pasuritë nëntokësore që mund t'i ketë komuna.

Në bazë të hulumtimeve që janë bërë deri më tani komuna ka këto pasuri nëntokësore:

- Gurë gëlqerorë
- Argjil i kualitetit të lartë për punimin e materialeve ndërtimore
- ~~Plumb dhe Zing (këto të dhëna janë marrë sipas disa hulumtimeve burimore sesa në bazë të hulumtimeve shkencore)~~ dhe së këto zona janë në fshatrat e Bajës dhe Syriganës.
- Xehet e Nikelit

Thëngjill- Sipas hulumtimeve të viteve 1983/84 nga instituti “INKOS” në kuadër të KEK-ut është bërë një hulumtim ku këto hulumtime kanë ardhur në përfundim se në fshatrat Polac dhe Prekaz të komunës së Skenderajt ka rezerva të thëngjillit prej 7.000.000 tonë në thellësi prej 10-15 m.

2.3 KARAKTERISTIKAT DEMOGRAFIKE TË SKËNDERAJT

2.3.1 Numri i popullsisë

Në komunën e Skënderajt sipas vlerësimeve jetojnë 51,317 banorë, që përbëjnë rreth 3% të banorëve të Kosovës. Nga numri i gjithmbarshëm i banorëve në komunë, 6612 (rreth 13%) jetojnë në zonën urbane dhe 87% që jetojnë në zona rurale. Regjistrimi i mëparshëm dhe vlerësimi i popullsisë i kryer nga autoritetet e Kosovës përfshin numrin e përgjithshëm të popullsisë, ndërsa të dhënat e regjistrimit të vitit 2011 përfshijnë vetëm popullsinë rezidente. Duke marrë këtë konsideratë mungesën e konsistencës, është e vështirë të jepet një vlerësim i saktë për numrin e rritjes së popullsisë gjatë viteve. Përveç numrit të banorëve rezident, vlerësohet se janë edhe rreth 15.000 persona nga Skënderajt të cilët jetojnë jashtë vendit.

Dendësia e banimit ka pasur rritje të vazhdueshme, por gjithmonë nën mesatarën e Kosovës. Në komunën e Skënderajt dendësia e banimit ndryshon nga njëri vendbanim në tjetrin. Vlera më të larta të kësaj dendësie arrihen në vendbanimet përgjate rrugëve kryesore sidomos në qytetin e Skënderajt. Dendësia e popullsisë në zonën urbane është të 1421.9 banorë për km², ndërsa në zonat rurale është 119.66 banorë km² për pothuaj se e njëjtë me nivelin e Kosovës - 177.4 banorë për km².

2.3.2 Mosha dhe gjinia

Pjesëmarrja e popullsisë me grupmoshë prej 0-20 vjet është me 47%, në grupmoshë 20-60 vjet 48%, dhe mbi 60 vjet është 5%. Karakteristikë e komunës së Skënderajt është dominimi i moshës së re me 47%, kjo paraqet një potencial të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik në të ardhmen. Në komunën e Skënderajt sipas burimit nga këshilli struktura gjinore është: meshkuj 25,879 ose 50.4%, femra 25,438 ose 49.6%.

2.3.3 Përkatësia etnike

Në komunën e Skënderajt jetojnë kryesisht banorë shqipëtar, mirëpo në territorin e kësaj komune jetojnë edhe pjesëtarë të komunitetit serb, romë dhe boshnjak. Përmbajtja e strukturës kombëtare për banorët e komunës së Skënderajt është si vijon: Populli shqiptarë është me 99.33%. Pjesëtarë të nacionalitetit serb janë 50 banorë, të nacionalitetit boshnjak 42 banorë, të komunitetit ashkali janë 10 (goran janë 1 dhe turq 1, ndërsa 4 banorë janë të padeklaruar).

2.3.4 Lëvizjet natyrore

Edhe komuna e Skënderajt sa i përket lëvizjes natyrore të popullsisë nuk dallon shumë nga lëvizja natyrore e popullsisë në nivelin kombëtar. Nataliteti në këtë komunë është 28% (SzhEK Skënderajt 2005-2010) ndërsa mortaliteti është 5%. Për krahasim, vlerat në nivel të Kosovës për vitin 2006 janë: nataliteti 16.3% ndërsa mortaliteti 3.6% (ESK - Ndryshimet Demografike 1948-2006). Pra edhe nataliteti edhe mortaliteti janë më të larta se sa mesatarja në nivel shtetëror. Sipas Entit të Statistikave të Kosovës, Lindjet në komunën e Skënderajt për vitin 2006 ishin 3.3%, ndërsa vdekjet 2.8% (Statistikat vitale të Kosovës 2006).

2.3.5 Lëvizjet mekanike

Kushtet për jetë më të mirë, qasja në shërbimet e kualitetit më të lartë, infrastruktura më e mirë është faktor kryesor i cili ndikon në lëvizjen e banorëve të kësaj komune, dhe atë nga drejtimi rural për në drejtimin urban. Shpopullimi i vendbanimeve edhe në këtë komunë është i theksuar dhe kjo ndodh prej vendbanimeve kodrinore malore në drejtim të qytetit të Skënderaj, dhe nga shkaku i koncentrimit të aktiviteteve kryesore në këtë qytet, si shërbimet kryesore publike, administrative, kulturore dhe aktivitetet ekonomike. Lëvizja mekanike e banorëve të kësaj komune është e theksuar gjatë viteve 90-ta, kur të rinjtë nga presionet e pushtetit serb, mosperspektiva për një të ardhme të qëndrueshme për jetë, u detyruan të lëvizin në drejtim të shteteve të Evropës, sidomos grupmoshat e reja dhe të afta për punë. Në komunën e Skënderaj janë regjistruar migrime të 1230 familjeve nga fshatrat drejt qytetit si dhe 20 familje nga Skënderaj jashtë komunës (SZhEK Skënderaj 2005-2010).

2.4 ARSIMI

Sistemi edukativo-arsimor në komunën e Skenderajt është i organizuar dhe funksionon në tri nivele.

- Arsimi parashkollor,
- Arsimi fillor,
- Arsimi i mesëm.

Në komunën e Skenderaj kemi një Institucion parashkollor (çerdhe) publik dhe një paralele e ndarë në fshatin Bajë ku janë të përfshirë 158 fëmijë. Në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme të ulëta të komunës së Skenderaj funksionojnë klasët parashkollore në të cilat janë të përfshirë 663 fëmijë. Nuk kemi shënime për fëmijët që janë të përfshirë në çerdhen private, ku në komunën tonë funksionon një e tillë.

Arsimi fillorë, i mesëm i ulët dhe i mesëm i lartë organizohet në 23 shkolla fillore dhe të mesme të ulëta si dhe në tri shkolla të mesme të larta ku janë të përfshirë 8361 nxënës, ndërsa në procesin edukativo-arsimorë janë të angazhuar 882 punonjës arsimorë dhe shërbyes të tjerë.

2.5 BANIMI

Komuna e Skënderaj në pjesën më të madhe karakterizohet me banim me veçori rurale dhe me dendësi të ulët. Shumica e njësive të banimit janë të reja, të ndërtuara pas luftës, si rezultat i shkatërrimeve të konsiderueshme. Përkundër ndërtimeve të reja, pasojat e luftës nuk janë eliminuar plotësisht. Nevoja për përmirësim e kushteve të banimit, qoftë drejtpërdrejt në njësi të banimit apo në shërbime të tjera që ndikojnë cilësinë e banimit është ende e dukshme, sidomos në zonat rurale. Ndërtimet nuk janë përcjellë gjithmonë shërbime adekuate publike, duke ndikuar edhe në kushtet mjedisore. Ndërkaq kapacitetet e krijuara banimore nuk përputhen plotësisht me nevojat aktuale për banim, duke lënë një pjesë të kapaciteteve të pashfrytëzuara.

2.5.1 Kapacitetet dhe tipologjia e banimit

Sipërfaqja e ndërtuar në Komunën e Skenderaj në pjesën më të madhe përbëhet nga sipërfaqet e banimit. Duke e pasur parasysh se mbi 80% e banorëve të komunës jetojnë në fshatra, tipi dominant i banimit është në bashkëpronësi. Numri i përgjithshëm i njësive të banimit është mbi 20500, prej të cilave shumica i përkasin banimit individual ndërsa një pjesë më e vogël atij shumëbanesor (në zonën urbane). Prej këtij numri të përgjithshëm, rreth 1100 njësi banesore (12.9%) janë të ndërtuara në zonën urbane dhe në këtë numër përfshihen edhe i tërë fondi i banimit shumëbanesor. Në nivel komunal banimi përfshinë 2071 ha. Sipas regjistrimit të vitit 2011 komuna e Skënderaj ka pasur gjithsej 10620 njësi të banimit. Si komunë rurale karakterizohet me banim me dendësi të ulët, me dominim të banimit individual.

2.5.2 Banimi në qendrën komunale

Banimi në kuadër të Skënderajt si vendbanim përfshin 131.1 ha. Pjesën më të madhe e përbën banimi kolektiv me etazhitet deri P+7. Banimi individual është i përqëndruar në zonat periferike, etazhiteti i njësive individuale të banimit shkon deri në P+3.

2.5.3 Banimi në fshatra

Banimi në fshatra përfshinë 1940.8 ha. Fondi i përgjithshëm i banimit në zonën rurale në tërësi përbëhet prej banimit individual, si banim me dendësi të ulët. Etazhiteti i njësive individuale të banimit shkon deri në P+3. Fshatrat që shquhen me numër më të madh të njësive të banimit janë Llausha (2744), Polaci (2701), Prekaz i Epërm (2126) dhe Klina e Poshtme (1927). Numri i njësive banesore në fshatrat tjerë është nën 557 njësi banimi.

2.5.4 Shfrytëzimi i kapaciteteve të banimit

Shikuar përgjithësisht, në nivel të komunës ekziston një shpërputhje në mes numrit të njësive të banimit (9864) dhe numrit të familjeve (7731). Nga fondi i tërësishëm i banimit në Skënderaj, rreth një e pesta, përkatësisht 23.5% mbetet i pashfrytëzuar. Mendohet që një numër i madh i njësive vakante të banimit janë në pronësi të njerëzve që jetojnë dhe punojnë jashtë vendit. Duke qenë se situatë e ngjashme është edhe në nivel të Kosovës, një përqindje kaq e lartë e njësive vakante duhet të merret parasysh gjatë shqyrtimit të banimit në aspekt të politikave dhe kapaciteteve. Kapacitetet ekzistuese të banimit social janë tri objekte. Të strehuara në këto objekte janë njëqind (100) familje të asistencës sociale. Gjendja e këtyre tri objekteve egzistuese plotëson kushtet për banim.

2.5.5 Vjetërsia e fondit të banimit

Sipas të dhënave të regjistrimit të fundit të vitit 2011, 90% e njësive të banimit janë ndërtuar në 30 vitet e fundit. Më shumë se 50% e njësive të banimit janë ndërtuar gjatë periudhës 2000-2010, që është më e lartë në krahasim me nivelin e Kosovës prej 35.8%. Ekziston një shtysë e madhe për ndërtimin e njësive të banimit, duke nënkuptuar jo vetëm rindërtimin e shtëpive të shkatërruara gjatë luftës, por edhe një rritje të fondit të banimit në periudhën 2000 - 2009 në krahasim me periudhat e mëparshme.

Nr. i shtëpive në kategorinë v	Të ndërtuara viti 2000	Të ndërtuara viti 2000	Të ndërtuara viti 2001	Të ndërtuara viti 2002	Përqindjet e ndërtimit %
4287	567	722	396	1685	39.31

Tabela 10. Shtëpitë e ndërtuara të kategorisë së (V) pestë sipas viteve Burimi: Drejtoria e Urbanizmit, Skënderaj

2.6 ANALIZË EKONOMIKE

Skenderaj, zhvillimin e vet e mbështet në resurset njerëzore dhe natyrore, në traditën e popullatës së kësaj ane dhe llogaritet si një vend i potencialit dhe traditës bujqësore, me agrikulturë, blegtori.

2.6.1 BUJQËSIA

Komuna e Skënderajt ka një territor prej 37,440 km². Tokë bujqësore konsiderohet të jetë rreth 21.149 ha ose 57%, prej së cilës shumica është tokë e punueshme me një pjesë të vogël për kullosa. Po ashtu, sipërfaqe pyjore janë rreth 14.685 ha ose 39 % dhe 1.606 ha ose 4 % djerrinë.

Kulturat bujqësore në këtë komunë janë kryesisht të orientuara nga mbjellja e drithërave, rritja e bagëtive të ndryshme, pemët dhe perimet, që prodhohen për nevojat e ekonomive familjare, dhe disa të tjera orientojnë prodhimin për profit.



Figura: Sipërfaqja tokësore

Zhvillimi i Sektorit të Bujqësisë në Komunën e Skënderajt mbetet me prioritet të lartë dhe konsiderohet si shtyllë kyçe për arritjen e Zhvillimit Ekonomik Lokal në këtë komunë. Më tutje, sektorët e bujqësisë me potencial zhvillimor janë konsideruar:

- Blegtoria
- Hortikultura
- Bletaria (Apikultura)
- Lavertaria
- Pylltaria

2.6.1.1 SEKTORI I BLEGTORISË

a) Nënsektori i gjedheve

Gradualisht është duke u zhvilluar, nga fondi total i gjedheve prej 7500 krerë, 3050 janë lopë qumështi. Racë e pastërt qumështore janë shumë pak, ku kemi 20 ferma që mbarështojnë lopë të races së pastërt, ndërsa afër 200 miniferma mbarështojnë me tip të racave të ndryshme si hollishtajn i kuq, hollishtajn i zi, simental etj. Ferma të specializuara për trashje të viçave në komunë janë 16, ndërsa fermerët tjerë rrisin viça mashkuj prej 3 deri në 9 muaj dhe i plasojnë në treg.

b) Nënsektori i kafshëve të imta (dhenëve dhe dhive)

Numri i fermave të dhive është 6 me 728 krerë. Dominojnë racat ballkanike dhe diku rreth 20% e dhive janë të racave Alpine si ajo e Francës, Zvicrës etj.

c) Bletët

Komuna numëron 200 bletarë me 7800 shoqëri. Në komunën e Skënderajt ka kushte ideale për t'u marrë më këtë veprimtari, nevojat e konsumatorëve plotësohen vetëm me 20 %.

2.6.1.2 SEKTORI I LAVËRTARISË DHE PERIMKULTURËS

Komuna e Skënderajt posedon kushte të përshtatshme klimatiko – tokësore, që mundësojnë organizimin e prodhimit të suksesshëm të kulturave lavërtare dhe perimore. Përpos kulturave bazike grurit dhe misrit, tani janë duke u rritur sipërfaqet në llogari të kulturave perimore si në ambient të hapur ashtu edhe në ambient të mbyllur.

- Sipërfaqet e mbjella me grurë 6500ha
- Sipërfaqja e mbjellë me elb 200ha
- Sipërfaqja e mbjellë me tërshër 1500ha
- Sipërfaqet e mbjella me miser 3500ha
- Sipërfaqet e mbjella me patate 50ha
- Sipërfaqet që mbillen me kultura perimore në fushë të hapur 350ha
- Sipërfaqet në ambiente të mbyllura (Serra) 50ha.
- Fasule monokulturë 18ha.
- ~~Mbështetja e fermerëve për aplikim në skemën e subvencioneve dhe granteve të MDPZIR.~~

Kultivimi i perimeve kërkon angazhim më të madh të fuqisë punëtore, ashtu që ndikon në punësim për disa here më të për sesa lëmitë tjera të bujqësisë. Shtimi i prodhimit të perimeve do të ndikonte në furnizimin e tregut dhe zbutjen e deficitit tregtar të tyre.

Shumica e kulturave perimore (domatja, speci, trangulli etj.) kanë origjinë nga viset e nxehta. Për këtë arsye, në fushë të hapur kultivimi i tyre është i mundur për një periudhë të shkurtër kohore. Në fushë të hapur kryesisht kultivohen shalqini, pjepri, lakra, qepa, hudhra, karrota etj. perime këto që kanë vegjetacion më të shkurtër.

Në kushtet tona klimatike, prodhimtaria e perimeve ka karakter sezonal. Prandaj, prodhimtaria në ambiente të mbyllura, paraqet një mundësi të mirë për ndryshimin e këtij karakteri sezonal.

Në vitet e fundit te ne, vërehet një orientim i madh i prodhuesve për këtë mënyrë të kultivimit të perimeve.

Intensifikimi i mëtejshëm i prodhimit të perimeve në ambiente të mbrojtura do të eliminonte karakterin sezonal të prodhimit dhe do të mundësonte furnizimin e vazhdueshëm të tregut me perime të freskëta gjatë tërë vitit me çmime të arritshme për konsumatorin.

Për nga aspekti ekonomik, kultivimi i perimeve në serra paraqet mënyrën më intensive me ç'rast arrihen rendimente mjaft të larta dhe afate kohore të planifikuara.

Plotësimi i nevojave të popullatës me perime sillet rreth 30-40 %.

Aktivitetet:

1. Paisja e 20 perimtarëve me serra komerciale me sipërfaqe 300m²
2. Paisja e 100 perimtarëve me serra gjysëm-komerciale me sipërfaqe 150m²
3. Mbështetja e perimtarëve për aplikim në skemen e subvencioneve dhe granteve të MBPZHR.

Sipas shenimeve që disponojm, në teritorin e komunës së Skënderajt me pemë frutore janë të mbjella gjithsej rreth 120 ha, kryesisht në kultivim gjysëm intensiv dhe intensiv.

2.7 PUNËSIMI

Komuna e Skënderajt, dikur kishte një ekonomi mjaft të zhvilluar dhe hynte në mesin e atyre komunave me një zhvillim të mirë ekonomik. Por me hyrjen e masave të përkohshme nga ana e regjimit serb pas suprimimit të Kosovës, zhvillimi ekonomik u shkatërrua, pasi u larguan nga puna e gjithë fuqia punëtore shqiptare. Edhe pas luftës me privatizimin e organizatave, nuk u arrit që ato të konsolidohen, andaj afaristët e tyre nuk mundën t'i përmbushin kriteret për rritjen e numrit të punëtorëve.

Në administratën komunale raporti i të punësuarve është: staf politik janë 16 punëtorë, shërbyes civilë janë 239, gjithsej janë 255 punëtorë.

Në sektorin privat të dhënat paraqiten në tabelë.

Tabela 1 e gjendjës së bizneseve nga viti 2000-2023

Sektori për Zhvillim Ekonomik- zyra për biznese	Lëndë
Biznese të reja të regjistruara	3120
Biznese formalisht aktive	2606
Biznese të shuara	514
Biznese aktive në funksion	505

Tabela 2 Bizneset aktive që operojnë në Komunën e Skënderajt dhe të punësuarit

Nr	Veprimtaria	Numri i bizneseve	Bizneset %	Numri i punëtorëve
1	Tregtia	212	42%	480
2	Automekanik, saldues, limari	43	9%	60
3	Frizer dhe sallone ondulimi	27	5%	33
4	Prodhimtari	26	5%	178
5	Mjekësi dhe veterinë	26	5%	51
6	Hoteleri dhe sherbime ushqimi	48	10%	100
7	Elektro dhe sherbime	17	3%	54

	telekomunikimi			
8	Autolarje	6	1%	12
9	Ndetimtari	24	5%	71
10	Agjencione dhe Sigurim	8	2%	7
11	Bujqesi	8	2%	12
12	Furrtari	6	1%	8
13	Autoshkolla	6	1%	15
14	Transport	8	2%	19
15	Farmaceutike	2	0%	5
16	Institucione financiare	11	2%	15
17	Perpunim dhe paketime	10	2%	34
18	Fotograf	4	1%	5
19	Sherbime keshillimore	3	1%	4
20	Lojera dhe argetim	4	1%	5
21	Tekstil	6	1%	7
Totali		505	100	1175

Sektori	Të punësuarit	Mesatarja e pagës/muaj
Privat	1175	328 euro
Gjithsejt	1175	Ndryshon

III. Vërejtje:

Të dhënat janë të përafërta, sepse numri i punëtorëve ndryshon kohë pas kohe, e që këto të dhëna nuk përcillen nga ATK (Administrata Tatimore) në regjistrin e ARBK-së (Agjencioni për Regjistrim të Bizneseve)

Po ashtu numri i bizneseve që operojnë nuk është krejt i saktë, për faktin se disa biznese e ndërprejnë aktivitetin dhe nuk lajmërojnë një gjë të tillë.

Në ekonominë joformale janë të punësuar një numër i konsiderueshëm i të rinjve, për të cilët nuk kemi të dhëna.

2.7.1. PAPANËSIA

Papunësia edhe në komunën e Skënderajt është një ndër problemet e theksuara, pasi një numër i madh i të rinjve të komunës sonë për shkak të papunësisë janë larguar dhe kanë shkuar në shtetet e perëndimit për të punuar dhe siguruar ekzistencën e familjeve të tyre.

Tabela 6. Punëkërkuessit e regjistruar në Zyrën Komonale në Skënderaj, periudha 01.01.2018 – 31.12.2023

Niveli i edukimit	Totali	Femra	Meshkuj
Të pashkollë	121	57	64
Klasat I-IX (shk. fillore)	42	17	25

Arsimi i Mesëm Profesional	176	99	77
Shkolla e Mesme-Gjimnazi	71	52	19
Bachelor	70	58	12
Master	8	3	5
Totali	488	286	202

Tabela 7. Punëkërkuës sipas etnicitetit

Etniciteti	Totali	Femra	Meshkuj
Shqiptar	486	285	201
Serb	2	1	1
Totali	488	286	202

Tabela 8. Punëkërkuës në bazë të moshës

Grupmosha	Totali	Femra	Meshkuj
15-24	196	132	64
25-39	191	109	82
40-54	72	27	45
55+	29	18	11
Totali	488	286	202

2.7.2 TË ARDHURAT MESATARE - GJENDJA SOCIALE

Sa i përket të të ardhurave mesatare ato pak dallohen nga të ardhurat në Republikën e Kosovës, Skënderaj e ka ngritur mirëqenien sociale në të gjitha fushat, shëndetësi, arsim, infrastrukturë, shërbime publike etj., dhe janë krijuar kushte më të mira për mirëqenien qytetare.

Vitet	Numri i familjeve	Numri i antarëve të familjeve
2014	1213	6.106
2015	1205	5.205
2016	870	3.991
2017	860	3.963
2018	826	3.802
2019	771	3.512
2020	812	3.659
2021	869	3.841
2022	777	3.430
2023	702	3.066

Tabela 9. Numri i familjeve që gjenden në Skemen e Asistencës Sociale

2.7.3 EKONOMIA/ POTENCIALI I KOMUNËS

Kosova ka një zhillim jo të balancuar ekonomik nëpër komuna, si pasojë e zhvillimit joproporcional infrastrukturor, potencial të ndryshueshëm të zhvillimit bujqësor, turistik, industrial, tregtar, zhvillimeve jo mirë të menaxhuar të kapaciteteve e resurseve humane dhe cilësisë së jetës së qytetarëve etj. Zhvillimi jo i balancuar në aspektin ekonomik shpreh çështjen e papunësisë, shkallën e ulët të të ardhurave personale, mungesën e investimeve nëpër sektor, si dhe investimet kapitale në lëmi të ndryshme. Të ardhurat për kokë banori - dallimet në të ardhura ndërmjet komunave janë të mëdha, banorët e komunave më të zhvilluara

fitojnë gati tre herë më shumë se ata në ato të pazhvilluarat. Përderisa, vlera mesatare e shkallës së papunësisë për Kosovën është 34.07%.

Komuna e Skënderajt ka shkallën e papunësisë rreth 65-75%. Komunë relativisht e varfër, e karakterizuar me mungesë të investimeve në të gjitha fushat zhvillimore që nga koha e Jugosllavisë. Bujqësia mbetet themeli i ekonomisë në këtë komunë, mirëpo toka e punëshme nuk është shfrytëzuar aq shumë. Për momentin pavarësisht remitencave, burim i të ardhurave janë ndërmarrjet e vogla si dyqanet familjare dhe restorantet. Dy fabrika që janë privatizuar prodhojnë tulla dhe miell dhe kanë të punësuar disa qindra persona. Burim kryesor i punësimit është Shërbimi Civil Komunal.

Bujqësia paraqet potencialin kryesor të zhvillimit ekonomik të komunës, ndërsa nuk është trashëguar ndonjë industri nga periudha e para luftës. Skenderaj ka kushte të mira edhe për zhvillimin e industrisë ekstraktuese, ndërtimit, industrisë së ushqimit dhe përpunimit, industrisë së materialit ndërtimor, që do të mund të ishin shtysë e rëndësishme për zhvillimin ekonomik të komunës. Potencialet për zhvillim ekonomik nuk janë shfrytëzuar plotësisht deri më tani, ndërsa Skënderaj i takon komunave më të pazhvilluara të Kosovës. Burimi kryesor i gjenerimit të të hyrave të qytetarëve të komunës së Skënderajt janë prodhimet e vogël, bujqësia (ekonomitë familjare) dhe tregtia. Në përgjithësi, mjedisi për zhvillimin e ndërmarrjeve ende mbetet i pafavorshëm dhe me mbështetje të pamjaftueshme.

Investimet publike në Komunën e Skenderajt pothuaj se tërësisht kryhen përmes buxhetit komunal. Bashkë-investime publiko-private me biznese deri më tani nuk ka pasur. Bashkë-investimet me komunitetin kanë qenë simbolike, por nuk janë aplikuar viteve të fundit.

Viteve të fundit buxheti komunal ka shënuar rritje, përveç në vitin 2015, kur shënon një rënie të lehtë.

1. ANALIZË E GJENDJES EKZISTUESE TË BANIMIT SOCIAL

Në vijim do të prezantohet gjendja aktuale lidhur me objektet në pronësi të komunës të dedikuara për banim social si dhe numri/profili i familjeve tani më të ndihmuara me sigurim të banimit. Po ashtu do të prezantohet kërkesa aktuale për banim në komunën e Skenderajt.

GJENDJA E PROGRAMEVE TREVJEÇARE TE VEÇANTA PER BANIM NE KOMUNAT E KOSOVES 2024							
Nr	Komuna	Periudha Kohore	Numri i familjeve te vendosura sipas kategorive				
			Rastet sociale	Rom ashkali egjiptian	F. e dëshm. inval.dheveteran.	Të kthyerit	Të riatdhes.
7	Skenderaj	2004-2024	55		43	2	

Gjithsej.....100 Familje

GJENDJA E PROGRAMEVE TREVJEÇARE TE VEÇANTA PER BANIM NE KOMUNAT E KOSOVES 2024							
Nr	Komuna	Periudha Kohore	Numri i kërkesave sipas kategorive				
			Rastet sociale	Rom ashkali egjiptian	F. e dëshm. inval.dheveteran.	Të kthyerit	Të riatdhes.
7	Skenderaj	2022-2023	25	1	6		

Gjithsej.....42 Familje që kërkojnë banim.

OBJEKTET KOMUNALE TË DEDIKUARA PËR BANIM SOCIAL

Objekti i parë është ndërtuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinore në bashkëpunim me SDC dhe Komunën në vitin 2004, në të cilin janë të strehuara 26 familje.

Të gjitha këto familje janë raste të asistencës sociale dhe të pa strehë. Janë të vendosura me kontrata dy vjeçare 2004-2006.

Në vitin 2022, është bërë verifikimi i gjendjes ekonomike të shfrytëzuesve në Qendrën e Banimit Social, nga ana e komisionit të emruar nga krytari i Komunës z.Fadil Nura, me vendimin 02Nr.020/01-0034257/22 të datës 18.07.2022.

Gjatë kësaj periudhe do të filloj renovimi i këtij objekti në bashkëpunim të Komunës së Skenderajt me Fondin e Kosovës për Eficiencë të Energjisë në kuadër të Be-së.



Figura: Objekti i parë i banimit social

Objekti i dytë është ndërtuar në vitin 2007 nga Emiratet e Bashkuara Arabe si dhe me participimin e komunës, në kete objekt janë të strehuara 25 familje. Të gjitha kwto familje janë raste të asistencës sociale dhe të pa strehë. Janë të vendosura me kontrata dy vjeçare 2007-2009. Në vitin 2022, është bërë verifikimi i gjendjes ekonomike të shfrytzuesve në Qendren e Banimit Social, nga ana e komisionit të emruar nga krytari i Komunës z.Fadil Nura ,me vendimin 02Nr.020/01-0034257/22 të datës 18.07.2022.

Gjatë kësaj periudhe do të filloj renovimi i këtij objekti në bashkëpunim të Komunës së Skenderajt me Fondin e Kosovës për Efiçiens të Energjisë në kuadër te Be-së.




Figura: Objekti i dytw i banimit social

Objekti i tretë është ndërtuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale si dhe me Partecipimin e Komunës, në të cilin janë të strehuara 49 familje. Pra në të tre objektet janë të strehuara gjithsej 100 familje.

Të gjitha keto familje janë raste të asistencës sociale dhe të pa strehë. Janë të vendosura me kontrata dyvjeçare 2009-2011.

Në vitin 2022 është bërë verifikimi i gjendjes ekonomike të shfrytëzuesve në Qendren e Banimet Social, nga ana e komisionit të emruar nga krytari i Komunës z.Fadil Nura ,me vendimin 02Nr.020/01-00342 57/22 të datës 18.07.2022.

Gjatë kësaj periudhe do të filloj renovimi i këtij objekti në bashkëpunim të Komunës së Skenderajt me Fondin e Kosovës për Eficiens të Energjisë në kuadër të Be-së.



Figura Objekti i tretë i banimit social

4.1 FAMILJET MOMENTALISHT TE NDIHMUARA ME BANIM SOCIAL

Në vitin 2015 janë ndihmuar 14 familje për ndërtimin e kulmeve dhe renovim të shtëpive në vlerën prej 21.500 €, po ashtu janë ndërtuar 4 shtëpi nga donatorët.

Në vitin 2016 nga Fondi i të Pastrehëve janë ndihmuar 44 familje për ndërtimin e kulmeve në vlerën prej 47.000 €, si dhe janë ndërtuar 4 shtëpi nga donatorët.

Në vitin 2017 nga fondi i të Pastrehëve janë ndihmuar 48 familje me ndërtimin e kulmeve në vlerën prej 57.000 €, si dhe nga donatorët janë ndërtuar 10 shtëpi për familjet në varfëri të skajshme.

Në vitin 2018 janë 68 kërkesa për ndërtimin e shtëpive, 33 kërkesa për banesa sociale si dhe për renovimin e shtëpive janë 75 kërkesa.

Këtë vit nga Fondi i të Pastrehëve janë ndihmuar 36 familje në vlerën prej 36.000 €, po ashtu janë ndërtuar 10 shtëpi dhe është blerë një banesë për një familje të Dëshmorit nga Jetimat e Ballkanit, të cilët kanë ndërtuar edhe 7 shtëpi, si dhe 2 shtëpi janë ndërtuar nga Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale, dhe një është ndërtuar nga Ministria për Komitete dhe Kthim.

Në vitin 2019 janë parashtrur 110 kërkesa për ndërtim të shtëpive prej tyre kanë përfitu 26 familjeve në varfëri të skajshme të cilat ju është ndërtuar shtëpia nga Shoqata “Jetimat e ballkanit” me bashkë participim edhe të Komunes, janë ndarë katër banesa për katër familje në varfëri të Skajshme nga Shoqata “Jetimat e Ballkanit”, dy shtëpi tjera janë ndërtuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale një Shtëpi është ndërtuar nga një donator Privat.

Në vitin 2020 janë parashtruar 45 kërkesa për ndërtim të shtëpive prej tyre kanë përfitu 7 familje në varfëri të skajshme të cilat ju është ndërtuar shtëpit nga donatorë të ndryshëm 5 familjev ju është ndërtuar shtëpia nga shoqata humanitare “Jetimat e Ballkanit”. Dy tjera nga donator tjerë.

Në Vitin 2021 janë bere 43 kërkesa ku prej tyre 3 familje janë ndihmuar me ndërtim te shtëpis si dhe 2 tjera me renovim te tyre.

Në Vitin 2022 janë bërë 42 kërkesa prej tyre 5 familje kanë përfituar në ndërtimin e shtëpive në bashkëpunim me donatorët e ndryshëm.

Ndërsa ne vitin 2023 janë parashtruar 18 kërkesa për ndërtim të shtëpive ku janë ndërtuar 2 shtëpi, ndërsa për renovim të shtëpive kemi pasur 35 kërkesa prej tyre 16 janë ndihmuar nga Subvencionimi i DSHMS-së.

KATEGORITË E SYNUARA

Kategorizimi dhe specifikimi do të rregullohet sipas bazës ligjore duke i definuar balancën ndërmjet kategorive të synuara nëpër vite të aplikimit sipas të cilit do të përcaktohen kriteret e caktuara për familjet përfituese të cilat do të kenë për bazë: karakteristikat sociale dhe ekonomike të familjeve që presin ndihmën nga autoritetet komunale për të zgjidhur problemet e banimit.

Ndër kategoritë që do të përfitojnë nga programet e banimit parashihen:

- Familjet që nuk kanë banesë apo shtëpi në pronësi individuale
- Familjet që posedojnë sipërfaqe banimi nën normat e banimit, të përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike.
- Kategoritë e dala nga lufta dhe ish të përndjekurit politik;
- Të kthyerit dhe komunitetet RAE (Minoritetet)
- Të riatdhesuarit

- Të moshuarit
- Të rinjtë
- Të punësuarit nga buxheti shtetëror
- Nënata vetushqyese-kryefamiljare

KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E RADHËS SË PËRPARËSISË

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit kriteret e përparësisë për sigurimin e banimit për kategoritë e cekura në pikën 7.1 janë:

- Statusi i banimit;
- Lartësia e të ardhurave
- Gjendja shëndetësore
- Invaliditeti
- Struktura e familjes

GJENDJA FAKTIKE – ANALIZA NË FORMË TABELARE

KOMUNA E SKENDERAJT			
Nr. i popullsisë:		51.317	
Zonat rurale		39718	
Zonat urbane		11599	
Nr. i fshatrave		52	
Banimi individual	Nr. objekteve para 1999		-
	Nr. objekteve pas 1999		-
	Etazhiteti mesatar		7
Banimi kolektiv	Para 1999	Nr. objekteve	-
		Nj. banimi	
	Pas 1999	Nr. objekteve	-
		Nj. banimi	
Etazhiteti mesatar		-	
Statusi pronësor (banim kolektiv) para 1999	Privat [nj. banimi]		-
	Shoqëror [nj. banimi]		-
Raporti banim individual/banim kolektiv në [%]			-
Krye në infrastrukturë të objekteve të banimit në [%]			-
Nr. i objekteve të pabanuara			-
Nr. i objekteve me vlerë kulturo historike që shfrytëzohen për banim			0
Aplikimi i masave termo-izoluese në objektet e banimit në [%]			-
Ndërtimet ilegale	Mbindërtimet		-
	ndërtimet tjera		-
	ndërtimet në pronë publike		-
Numri i kërkesave për zgjidhjen e çështjes së banimit			42
Lokacionet (sipërfaqja e tokës) për programet e veçanta të banimit			-
Nr. i objekteve/nj. banimi e ndërtuara nga Komuna, Qeveria dhe Donatorët			Komuna- janë ndertu 55 Shtëpi-5 banesa me ndihmen e

		donatorve dhe bashkëfinancim me Komunen për 3 vite.
Nr. i objekteve/nj. banimi me qira nga dhe vlera mes. e qirasë		
Nr. i objekteve/nj. banimi të disponueshëm për qira të ulëta të tregut		0
Nr. i objekteve/nj. banimi në pronësi të Komunës që duhet të rinovohen		0
Qendrat përkohshme kolektive (QPK)	Numri i QPK	3
	Vendndodhja /emërtimi	Skenderaj
	Nr. i familjeve	100
	Nr. i banorëve	398
Planet rregulluese - sa janë bërë dhe sa janë që duhet të bëhen		PZHV PZHK PZH hapësinor

PLANIFIKIMI KONKRET PËR NDIHMË PËR BANIM SOCIAL

Programi për banim në Komunën e Skënderajt është hartuar për periudhën 2024-2026. Komisioni i formuar nga ana e kryetarit të komunës ka bërë analizë të gjendjes ekzistuese dhe ka përgatitur propozime konkrete për të ndihmuar qytetarët e komunës së Skënderajt që nuk kanë mundësi të sigurojnë qeshtjen e banimit. Përpos ndihmës konkrete për qytetarët e vet, brenda kësaj periudhe trivjeçare do të vazhdohet me analiza për gjendjen e banimit social në kuadër të Komunes.

Programi i prezantuar trevjeçar për Banim si objektiv kryesor ka:

O/1. Sigurimin e banimit për familjet e cenueshme.

O/1- SIGURIMI I BANIMIT PËR FAMILJET E CENUESHME

Prioritet kryesor i këtij programi është që në periudhën tre vjeçare komuna e Skënderajt të jetë në gjendje të i ndihmojë familjet në nevojë duke ju siguruar banim social.

Kjo do të bëhet në përputhje të plotë me Ligjin për Financimin e Programeve Trevjeçare për Banim si dhe Ligjin për vetqeverisje lokale Nr03/L-040. Sipas këtyre ligjieve, sigurimi i banimit bëhet përmes financimit të programeve të veçanta të banimit, ku përfshihen:

- banesat e ndërtuara nga komuna, qeveria dhe donatorët të cilat jepen në shfrytëzim me kohe të caktuar;
- banesat ekzistuese në pronësi të personave fizikë apo juridikë, të cilat mund të jepen me qira për familjet që posedojnë bonus të banimit;
- banesat tjera në pronësi të komunës, që mund të adaptohen për shfrytëzim në bazë të programeve të veçanta për banim.

Bonus banimi

Një formë tjetër, me të cilën Komuna e Skënderajt planifikon të ndihmojë familjet në nevojë për banim social, është përmes banesave ekzistuese në pronësi të personave fizikë apo juridikë, të cilat mund të jepen me qira për familjet që posedojnë bonus të banimit.

Në këtë formë, Komuna e Skënderajt planifikon të ndihmojë familje e cenueshme në tri vitet e ardhshme.

Kjo formë e ndihmës do të paguhet e tëra nga buxheti Komunal përkatësisht nga Subvencione e Drejtorishis se Shendestesis dhe Mireqenies Sociale.

Banesat në pronësi të komunës, që mund të përshtaten për banim social

Komuna e Skënderajt për momentin nuk posedon ndonjë objekt, i cili do të mund të rinovohet. Sidoqoftë, gjatë periudhës trivjeçare, Komuna e Skënderajt do të angazhohet që të zgjidhë statusin e banimit për familjet në nevojë për banim.

Banimi individual

Komuna e Skënderajt do të vazhdojë komunikimin me donatorë të ndryshëm, të cilët janë të interesuar të ndihmojnë familjet të cilat kanë nevojë për banim që t'u ndërtohen/rinovohen shtëpi individuale. Kjo është forma më e qëndrueshme për të siguruar banimin për këto familje.

ANALIZA E FAKTEVE – PËRMBLEDHJE

1.	Qëllimi i hartimit të programit tre vjeçare	Qëllimi kryesor i përpilimit të Programit Trevjeçar në Komunën e Skënderajt është që të ndihmohen familjet, të cilat kanë nevojë për banim social e nuk kanë mundësi vetanake për të siguruar strehë mbi kokë.
2.	Baza ligjore	Ky program bazohet në legjislaturën ekzistuese të Republikës së Kosovës të përshkruar më detajisht në kapitujt e sipërm të këtij dokumenti. Sidoqoftë dy dokumentet kryesore janë Ligji për Financimin e Programeve të Veçanta për Banim (03/L – 164) dhe Udhëzuesin për Hartimin e Programeve Trevjeçare për Banim. Ky program mundëson një lidhje organike midis mandatit 4-vjeçar të pushtetit lokal dhe projekteve komunale në fushën e banimit. Është i paraparë afati 3-vjeçar, të jetë më i përshtatshëm për të hartuar dhe për të dhënë në jetë programet e banimit, duke marrë parasysh veçoritë e Komunës së Skënderajt, si p.sh: politikat komunale të banimit (si veçoritë përkatëse), pozita gjeografike, demografike dhe institucionale.
3.	Llojet e programeve të konsideruara si të nevojshme	Në program do të parashihet bonus banimi si një formë shumë e mirë për të ndihmuar familjet në nevojë për banim social. Në tri vitet në vijim Komuna e Skënderajt planifikon të ndihmojë familjet e cenueshme përmes pagesës së qeras duke u referuar qmimit minimal të tregut. Në këtë program përfshihet edhe ndërtimi, renovimi i shtëpive individuale përmes buxhetit të komunës si dhe bashkëpunimit me Donator të ndryshëm.

4.	Prezantimi i gjendjes faktike	Komuna e Skënderajt nuk ka ndërtesa të banimit kolektiv të ndërtuara, por kemi tri objekte të banimit social. Objekti një (1) i banimit social është ndërtuar nga Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapsinor me participim edhe të Komunës me 10%, janë strehuar 26 familje. Objekti i dytë (2) i banimit social është ndërtuar nga Emiratat e Bashkuara Arabe me participim edhe të Komunës me 10%, janë strehuar 25 familje. Objekti i tretë (3) i banimit social është ndërtuar në vitin 2009 nga Ministrija e Punës dhe Mirëqenies Sociale me participim edhe të Komunës prej 10%, janë strehuar 49 familje.
5.	Kërkesat faktike për përkrahje me sigurim të banimit	A) Familjet që nuk kanë banesë apo shtëpi B) Familjet që nuk posedojnë sipërfaqe banimi C) Familjet që janë me kategori sociale, nënat vetëushqyese D) Të riadhesuarit, kategoritë e dala nga lufta dhe komunitete.
6.	Klasifikimi i nevojave sipas urgjencës së trajtimeve të tyre	Sipas kriterëve do të përcaktohen sipas ligjit nr. 03/L - 164, sipas komisionit të caktuar nga kryetari i komunës. Shpresojmë që edhe softueri për regjistrimin e përfituesve do të ndihmojë shumë në këtë drejtim.
7.	Veprimet kryesore që do të ndërmerren	<ul style="list-style-type: none"> • Regjistrimi i aplikuesve; • Vendosja e tyre në Data Bazë; • Vizita në terren; • Krijimi i listës prioritare për ndihmë sipas mundësive buxhetore; • Nënshkrimi i kontratës me përfitues të banimit social; • Mirëmbajtja e ndërtesave në bashkëpronësi të dedikuara për banim social;
8.	Kohëzgjatja e realizimit të programeve	2024-2026
9.	Kornizën e shpenzimeve afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë	Për çdo vit komuna, respektivisht përmes Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, janë ndarë mjete për ndërtim, rinovim të shtëpive, në bazë të kërkesave të qytetarëve, pas kërkesave të tyre, ku komisioni ka bërë vlerësimin.
10.	Mundësitë e kapaciteteve njerëzore dhe materiale	Planifikimi i buxhetit Donatorët DSHMS
11.	Mënyra e financimit të programeve tre vjeçare (të plotësohet më detajisht në dokumentin me programet trevjeçare të banimit)	Buxheti komunal Niveli qendror Donator
12.	Përputhja e programeve me planet zhvillimore të komunës	PZHK dhe PZHU i miratuar ku janë definuar zonat e banimit
13.	Instrumentet e garantimit të realizimit të programeve	Monitorimin, raportet vendimet e asamblesë komunale dhe programet e ndryshme të caktuara.
14.	Transparenca me hartimin dhe zbatimin e programeve	Analizë, debate publike me ekspertë të ndryshëm, raportet etj.

REZULTATET PAS ZBATIMIT

Programi për Banim është hartuar në mënyrë që të mund të zbatohet, të matet dhe të monitorohet. Monitorimi është një tipar i domosdoshëm për shkak se siguron që veprimet janë zbatuar dhe se përpjekjet janë duke u bërë për të siguruar përshtatjen me ndryshimet në burimet e disponueshme dhe të nevojshme.

Pas përfundimit të çdo projekti, në mënyrë transparente do t'i komunikohet publikut.

Masat që janë marrë për respektimin e kuadrit ligjor

Kjo pjesë do të jetë në vazhdimësi pjesë e punës së autoriteteve komunale, për të cilat do të zbatohet monitorimi dhe auditimi.

Përfshirja e publikut në procesin e sigurimit të transparencës

Publiku si sovrani i komunës, do të ketë të drejtën të dijë mënyrën se si shpenzohen të ardhurat e komunës në tërësi dhe ato të programeve trivjeçare në veçanti dhe do të sigurohet duke përfshirë publikun në procesin e sigurimit të transparencës si:

- zhvillimin e takimeve konsultuese me publikun;
- bërja e anketimeve apo studimeve të ndryshme për marrjen e mendimit të publikut;
- bërjen publike të programeve dhe projekteve që përfshijnë ato
- sigurimit të pjesëmarrjes së publikut gjatë diskutimeve që organet përkatëse do të zhvillojnë për hartimin, miratimin dhe zbatimin e programeve;
- bërjen e njoftimeve të ndryshme në mjetet e informimit publik apo në vend njoftimet komunale për aktivitetet ku mund të sigurohet pjesëmarrja e publikut
- çdo masë tjetër e cila vlerësohet e nevojshme në përmbushje të këtij qëllimi.

ANALIZA SWOT

Përparësitë	Dobësitë- Mangësitë
1. Ekzistimi i programit;	1. Mjete të pamjaftueshme buxhetore;
2. Iniciativa për zgjidhjen e banimit;	2. Infrastruktura përcjellëse;
3. Planifikimi buxhetor;	3. Mirëmbajtja e objekteve të banimit social
4. Të dhënat për nevojat e banimit;	4. Mungesa e programeve të veçanta për banim social
5. Ligji për programet e veçanta të banimit;	5. Mungesa e hapësirës për shërbime
6. Strategjia komunale	6. Kapacitetet jo të mjaftueshme komunale për zhvillimin e banimit social
7. Interesimi i qytetarëve për pjesëmarrje në këto programe	7. Kosto e lartë e banimit dhe kualiteti i ndërtimit
8. Të dhënat e sakta për kërkuesit	8. Mungesa e interesimit të grupeve tjera pjesëmarrëse
9. Burimet njerëzore të interesuar për këto	
10. Programe të veçanta	

Mundësitë	Rreziqet
<ol style="list-style-type: none"> 1. Lista e kërkuesve; 2. Donatorët; 3. Identifikimi i banesave private që janë të lira; 4. Programe të përbashkëta me partnerë ndërkombëtarë në fushën e banimit 5. Programet në nivel qendror në mbështetje në nivel lokal nga fusha e ndërtimit (banimit) 6. Skemat garantuese 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Jostabiliteti politik 2. Rritja e numrit të kërkesave; 3. Dëmtimet e paparashikuara gjatë asaj periudhe të banimit; 4. Mosrealizimi i programeve për mungesë të fondeve; 5. Niveli i lartë i varfërisë 6. Problemet e vazhdueshme ekonomike dhe financiare 7. Papunësia dhe mungesa e punësimit

PËRFUNDIMI

Komuna e Skënderajt, ka qenë në mesin e atyre komunave që ka hartuar edhe në të kaluarën Program për banim social të qytetarëve. Kështu duke e parë nevojë e vazhdimit të Programit për banim social, kryetari i komunës ka marrë vendim për formimin e komisionit, i cili do të hartojë programin 3-vjeçar për banim social dhe me këtë program të kemi të drejtë të konkurrojmë për ndonjë donacion për ndërtimin e një objekti social gjatë këtyre tre vjetëve. Nëvoja për hartimin dhe zbatimin e efektshëm të Programit për Banim sipas programeve të veçanta, kërkon koordinimin e aktiviteteve të të gjithë akterëve në kuadër të komunës, në përputhje me kompetencat e përcaktuara.

Në këtë drejtim është kemi caktuar Kordinatorin për Banim Social si një organ përgjegjës, që në mënyrë aktive të zhvillojë procesin e zbatimit të aktiviteteve të reja të banimit, sipas standardeve përmes fondeve nga buxheti komunal, qeverisë dhe në partneritetet publiko-private, që do të sigurojnë banim për grupe të caktuara dhe të ndihmohen në strehimin e këtyre kategorive të marginalizuara.

Bazuar në këtë, zhvillimi i banimit orientohet nga këto parime:

- përkrahja në zgjidhjen e çështjes së banimit,
- Stimulimi i ofertës dhe kërkesës,
- Mbështetje për grupet e rrezikuara për zgjidhjen e problemit të banimit,
- Mirëmbajtja dhe menaxhimi i ndërtesave për banim social.

Pyetjet e anëtareve për ekzekutivin e Komunës

1. Për Kryetarin Fadil Nura: Kryetar deri ku ka arrite projekti në realizimin e fabrikës së industrisë së drurit dhe prodhimeve të betonit në Fshatin Polac, i miratuar në dhënien në shfrytëzim afatgjatë deri 99 vite nga kuvendi komunal në seancën e datës 29.04.2022.
-Po ashtu kryetar a keni mundësi të na njoftoni deri ku ka arritur të konkretizohet “Projekti Solar në fshatin Leçine” ku kuvendi komunal ka dhënë pëlqimin në këtë projekt?
2. Për Drejtorin për Urbanizëm Ylber Morina: Drejtor a mund që me mundësit buxhetore për këtë vit të intervenoni në rrugën "Martiret e Polacit" prapa xhamisë e cila është e dëmtuar jashtëzakonisht shumë, dhe kërkohet në intervenim nga banoret e asaj lagje!

Afrim Kabashi-NSD

1. Pyetje për Drejtorin e Urbanizmit: Për Tribunat e stadiumit a pritët me fillua në këtë vit se veç javë keni rrënuar lokalet dhe s’është kah punohet hiq u kanë 5 muaji kurse ata njerëz tu prit për lokale?

Naser Bajraktari-IDEAL

1. Pyetje për Drejtorin e urbanizmit: Drejtor, a ke mundësi me tregu diçka për ujësjellësin që iu mundëson ujë të pijshëm fshatit Kryshec dhe Marine, kur pritët me fillua ky projekt, pasi që është bërë matja prej lokacionit Rezallë deri në Kryshec, si dhe në buxhet a keni parapare për vitin 2024 këtë ujësjellës?
2. Drejtor, a ke mundësi me na sqarua diçka për rrugën e Kozhices, a pritët me e qua këtë rrugë deri në Qyqavice apo u ndërpre, e nëse nuk është ndërpre pse nuk po vazhdoni me e qua rrugën deri në Qyqavice.
3. Drejtor, a ke mundësi me na sqarua diçka sa i përket kanalizimeve në fshatin Mikushnice, në disa lagje siç janë lagja “Shabani”, lagja “Ferizi”, lagja “Islami”, lagja “Zenuni”, pse nuk janë të kryera kanalizimet edhe a keni parapare për këtë vit që këto kanalizime të përfundojnë?
Ju lutem na sqaroni

Abdulla Gashi-IDEAL